LIGJ
Nr. 61/2012

PËR AKCIZAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË[1]

(Ndyshuar me ligjet nr. 180/2013, datë 28.12.2013[2], nr.142/2014, datë 23.10.2014, nr.158/2014, datë 27.11.2014, nr. 140/2015, datë 17.12.2015, nr. 126/2016, datë 15.12.2016, nr.108/2017, datë 30.11.2017, nr. 98/2018, datë 3.12.2018; nr. 114/2021, datë 25.11.2021)[3]

(I përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

TITULLI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

KREU I
FUSHA E ZBATIMIT DHE PËRKUFIZIMET E PËRGJITHSHME

Neni 1
Fusha e zbatimit

Ky ligj përcakton rregullat e përgjithshme për prodhimin, mbajtjen, magazinimin, lëvizjen dhe kontrollet mbi produktet që i nënshtrohen detyrimeve të akcizës, si dhe vendos rregullat

---

[1] Ky ligj është përafruar pjesërisht me:
Direktivën e Këshillit 2008/118/KE, datë 16 dhjetor 2008 "Lidhur me masat e përgjithshme mbi taksën e akcizës, e cila shfuqizon direktivën 92/12/KE", Numri CELEX: 32008L0118, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr. 9, datë 14. 1. 2009, faqe 12 – 30;
Rregulloren e Parlamentit Europian dhe Këshillit 450/2008, datë 23 prill 2008 "Mbi Kodin e Modernizuar Doganor", Numri CELEX: 32008R0450, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr. 145, datë 4. 6.2008, faqe 1 – 64.

[2] "Ky ligj hyn në fuqi menjëherë, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2014.
Përjashtimisht, neni 1 hyn në fuqi në datën 1 prill 2014" (neni 14).

[3] Ligji nr. 180/2013, datë 28.12.2013 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 203, datë 30 dhjetor 2013.
Ligji nr.142/2014, datë 23.10.2014 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 174, datë 14 nëntor 2014.
Ligji nr.158/2014, datë 27.11.2014 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 195, datë 24 dhjetor 2014.
Ligji nr. 140/2015, datë 17.12.2015 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 244/2015, datë 11 janar 2016.
Ligji nr. 126/2016, datë 15.12.2016 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 250, datë 27 dhjetor 2016.
Ligji nr.108/2017, datë 30.11.2017 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.222, datë 19 dhjetor 2017 dhe hyn në fuqi në 1 janar 2018.
Ligji nr. 98/2018, datë 3.12.2018 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 187, datë 28 dhjetor 2018 dhe hyn në fuqi në 1 janar 2019.

specifike mbi akcizën që zbatohet mbi konsumin e produkteve energjetike, alkoolin dhe pijet alkoolike, duhanin dhe nënproduktet e tij.

Deri në momentin e aderimit në BE, termi akcizë do të përdoret edhe për produktet e tjera, të përcaktuara në këtë ligj.

Neni 2
Përkufizime të përgjithshme

Në këtë ligj dhe në aktet të tjera nënligjore, në zbatim të tij, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Administratë doganore" janë strukturat qendrore dhe vendore të Shërbimit Doganor Shqiptar që, në zbatim të kompetencave të tyre, janë të ngarkuara me administrimin e akcizës.

2. "Akcizë" është një taksë që zbatohet mbi produktet e akcizës, të prodhuara dhe të importuara, që hidhen për konsum në territorin e Republikës së Shqipërisë.

3. "Produkte që i nënshtrohen akcizës" janë:

a) produktet energjetike;

b) alkooli dhe pijet alkoolike;

c) duhani e produktet e duhanit;

ç) produktet e tjera, të përcaktuara nga ky ligj.

4. "Depozitues i miratuar" është një person fizik ose juridik, i autorizuar nga autoritetet doganore në ushtrimin e aktivitetit të tij për të prodhuar, përpunuar, mbajtur, pritur ose dërguar produkte që i nënshtrohen akcizës nën regjimin e pezullimit të detyrimeve në një magazinë fiskale.

5. "Regjim doganor pezullues" është një nga procedurat apo regjimet e parashikuara në Kodin Doganor të Republikës së Shqipërisë, që ka të bëjë me mbikëqyrjen doganore të mallrave joshqiptare gjatë futjes së tyre në territorin doganor shqiptar, në magazinimin e përkohshëm, në zonat e lira ose magazinat e lira ose në një nga regjimet e parashikuara në këtë Kod.

6. "Regjim i pezullimit të detyrimeve" është një regjim që zbatohet në prodhimin, përpunimin, mbajtjen ose lëvizjen e mallrave të akcizës të pambuluara nga një procedurë doganore pezulluese ose regjim doganor pezullues, i cili ka pezulluar pagesën e akcizës.

7. "Importim i mallrave të akcizës" është futja në territorin shqiptar të mallrave të akcizës që, në momentin e hyrjes, nuk janë futur në një "Procedurë doganore pezulluese" ose "Regjim doganor pezullues", si dhe dalja e mallrave të akcizës nga një "procedurë doganore pezulluese" ose "regjim doganor pezullues".

8. "Pritës i regjistruar" është një person fizik ose juridik, i autorizuar nga autoritetet doganore për ushtrimin e aktivitetit të tij dhe sipas kushteve të përcaktuara nga këto autoritete, për të pritur mallra akcize që lëvizin nën një regjim pezullues të detyrimeve brenda territorit të vendit. Ky operator nuk mund të prodhojë, të mbajë ose të dërgojë produkte me pezullim të detyrimeve të akcizës.

9. "Dërgues i regjistruar" është një person fizik ose juridik, i autorizuar nga autoritetet doganore në ushtrimin e aktivitetit të tij dhe sipas kushteve të përcaktuara nga këto autoritete, vetëm për të dërguar produkte të akcizës në një regjim pezullues të detyrimeve pas çlirimit të tyre për qarkullim të lirë sipas dispozitave përkatëse të Kodit Doganor.

10. "Magazinë fiskale" është një ambient, qartësisht i ndarë nga ambientet e tjera, ku produktet e akcizës prodhohen, përpunohen, mbahen, priten ose dërgohen nën një regjim pezullues të detyrimeve nga një depozitues i miratuar në ushtrimin e aktivitetit të tij, sipas kushteve të përcaktuara nga autoritetet doganore.

11. "Territor" është territori doganor, sipas përcaktimit përkatës në Kodin Doganor të

Republikës së Shqipërisë.

12. "Përfaqësues fiskal" është një person juridik ose fizik, i miratuar dhe i licencuar nga autoritetet doganore, që vepron në emër dhe për llogari të depozituesit të miratuar, pritësit dhe dërguesit të regjistruar.

13. "Borxh" është detyrimi që ka depozituesi i miratuar, pritësi dhe dërguesi i regjistruar, përfaqësuesi fiskal ose çdo person tjetër, sipas këtij ligji, për të paguar shumën e detyrimeve të akcizës, që zbatohet për produktet që i nënshtrohen detyrimit të akcizës.

14. "Autorizim akcize" është autorizimi i lëshuar nga autoritetet doganore ndaj një personi fizik ose juridik, përmes të cilit këta të fundit, si pjesë e aktivitetit të tyre, mund të presin, të prodhojnë, të ruajnë, të magazinojnë ose të kryejnë operacione të tjera me produktet e akcizës në magazinat fiskale dhe të dërgojnë produkte akcize nën regjimin e pezullimit të detyrimeve.

15. "Përdorues i përjashtuar" është një person fizik ose juridik, të cilit i është dhënë një autorizim nga autoritetet doganore, sipas të cilit ai, si pjesë e aktivitetit të tij dhe për qëllime sipas seksionit 3 "Përjashtimet", mund të blejë produkte akcize pa qenë subjekt i pagesës së akcizës.

16. "Pullë e akcizës" është pulla e akcizës e Qeverisë Shqiptare, e përdorshme në përputhje me këtë ligj për produktet që do t'u vendoset kjo pullë akcize dhe që renditen në shtojcën 1, seksionet 2 dhe 3, përveç birrës së prodhuar në vend, për të cilën do të vendoset një kod sigurie.

17. "Pullë fiskale" është pulla e Qeverisë Shqiptare, që u aplikohet produkteve të akcizës, në formën e pullës së akcizës ose kodit të sigurisë.

18. "Kod i sigurisë" është një shenjë direkte që aplikohet për produktet e birrës apo në produkte të tjera të pijeve alkoolike që prodhohen në Shqipëri nga prodhuesit në shkallë të madhe apo importohen nga importuesit e autorizuar për këtë qëllim nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

19. "Prodhuesit në shkallë të madhe" janë prodhuesit e përcaktuar si të tillë me udhëzim të Ministrit të Financave.

Neni 3

Përfaqësuesi fiskal

1. Depozituesi i miratuar, dërguesi dhe pritësi i regjistruar mund të përcaktojnë një përfaqësues fiskal që vepron në emër dhe për llogari të tij.

2. Përfaqësuesi fiskal duhet në veçanti:

a) të garantojë pagesën e akcizës, sipas akteve ligjore në fuqi;

b) të paguajë akcizën brenda afateve të përcaktuara;

c) të mbajë regjistrimet/kontabilitetin për mallrat e marra dhe t'u paraqesë autoriteteve doganore dokumentacionin shoqërues të mallit dhe vendin e dorëzimit të tij.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave licencon personat që kërkojnë të kryejnë veprimtarinë e përfaqësuesit fiskal. Përfaqësuesi fiskal pajiset me një kod të veçantë.

4. Procedurat e licencimit përcaktohen me udhëzim të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave.

KREU II

LINDJA, DEKLARIMI, PAGESA, PËRJASHTIMI, HUMBJET DHE FIROT, DUTY FREE SHOPS DHE BAGAZHET PERSONALE, RIMBURSIMI, SHUARJA, KLASIFIKIMI FISKAL, KUSHTET E PAGESËS, NIVELI I DETYRIMEVE, MËNYRA E LLOGARITJES

Seksioni 1
Momenti dhe vendi i lindjes së detyrimeve të akcizës, deklarimi, pagesa

Neni 4
Lindja e detyrimit të akcizës

1. Për mallrat e akcizës detyrimi i akcizës lind në momentin e hedhjes së mallit për konsum në territor.

2. Për qëllime të këtij ligji, konsiderohen hedhje për konsum në territor:

a) dalja, përfshirë edhe daljen e parregullt, e produkteve të akcizës nga një regjim i pezullimit të detyrimeve;

b) mbajtja e produkteve të akcizës jashtë një regjimi pezullues të detyrimeve, ku akciza nuk është vjelë sipas këtij legjislacioni;

c) prodhimi, përfshirë edhe prodhimin e parregullt, i produkteve të akcizës, jashtë një regjimi të pezullimit të detyrimeve;

ç) importi, përfshirë edhe importin e parregullt, i produkteve të akcizës, me përjashtim të rastit kur produktet, menjëherë pas importit, janë futur nën një regjim të pezullimit të detyrimeve.

3. Moment i hedhjes për konsum është gjithashtu:

a) momenti i dërgimit të produkteve të akcizës nga një depozitues i miratuar drejt një personi juridik ose fizik, që nuk është i autorizuar të presë mallra akcize nën regjimin e pezullimit të detyrimeve;

b) momenti i prodhimit të produkteve të akcizës përtej sasive të parashikuara në nenet 66 e 73 të këtij ligji;

c) momenti i konsumimit të produkteve të akcizës për qëllime vetjake brenda ambienteve të magazinës fiskale;

ç) momenti i krijimit të humbjeve apo firove të produkteve të akcizës, me përjashtim të humbjeve dhe firove të shfaqura gjatë periudhës së pezullimit të detyrimeve, nëse depozituesi i miratuar mund të provojë që këto humbje apo firo kanë ardhur si rezultat i një ngjarjeje të paparashikuar ose force madhore, ose që këto humbje a firo të lidhura në mënyrë të pandashme me karakteristikat e produktit janë shfaqur gjatë prodhimit, magazinimit dhe transportit të produkteve të akcizës;

d) dita kur autorizimi i depozituesit të miratuar ose autorizimi i përjashtimit nga detyrimi i akcizës pushojnë së qeni të vlefshëm, sipas dispozitave të këtij ligji;

dh) momenti kur pritësi i regjistruar merr mallra akcize nën regjimin e pezullimit të detyrimeve, sipas nenit 30 të këtij ligji.

Neni 5
Momenti i lindjes së detyrimit të akcizës në import
(ndryshuar me ligjin nr. 142/2014, datë 23.10.2014)

1. Në rastet e importit të mallrave të akcizës, detyrimi i akcizës lind në momentin e lindjes së borxhit doganor, sipas përcaktimeve përkatëse të Kodit Doganor, me përjashtim të rasteve kur detyrimi i akcizës pezullohet sipas dispozitave të këtij ligji.

2. Në rast të iniciativave për ndryshime ligjore, që kanë për qëllim rritjen e nivelit të taksimit të akcizës, sasia e importit të mallrave të akcizës nga çasti i vendimit të Këshillit të Ministrave për propozimin për rritjen e saj deri në hyrjen në fuqi të ligjit për këtë nivel të akcizës, nuk mund të jetë më e lartë se 5 për qind më shumë se mesatarja mujore e vitit paraardhës, e importuar nga çdo operator i

regjistruar në Republikën e Shqipërisë.

Neni 6

Momenti i lindjes së detyrimit të akcizës për mallrat e konfiskuara, bashkimin e shoqërive tregtare, falimentin

Detyrimi për pagesën e akcizës lind, gjithashtu, edhe kur:

a) autoritetet doganore shesin ose japin për një qëllim të caktuar mallrat e akcizës, të konfiskuara, me përjashtim të rasteve kur ato i shiten ose i jepen depozituesve të miratuar ose përdoruesve të përjashtuar;

b) produktet e akcizës hidhen në konsum gjatë bashkimit të shoqërive tregtare, me përjashtim të rasteve kur blerësi është, gjithashtu, depozitues i miratuar ose përdorues i përjashtuar;

c) pas bashkimit të shoqërive tregtare, dërgohen produkte akcize te shoqëria tregtare e bashkuar, me përjashtim të rasteve kur shoqëria tregtare e bashkuar është depozitues i miratuar ose përdorues i përjashtuar, jo më vonë se 60 ditë kalendarike nga plotësimi i aplikimit për regjistrimin e bashkimit në QKR;

ç) produktet e akcizës janë hedhur për konsum ose dërguar te kreditori gjatë procedurave të falimentimit, me përjashtim të rasteve kur kreditori është depozitues i miratuar ose përdorues i përjashtuar.

Neni 7

Momenti i lindjes së detyrimit të akcizës për operacionet e parregullta

Detyrimi për të paguar akcizën lind, gjithashtu, kur është vërtetuar se produktet e akcizës:

a) janë prodhuar, importuar, blerë, transportuar, përdorur ose konsumuar në mënyrë të parregullt ose janë hedhur për konsum në mënyrë të parregullt, sipas përcaktimeve të këtij ligji;

b) janë dërguar ose përdorur nga përdoruesi i përjashtuar për qëllime të tjera nga ato të përcaktuara në autorizim.

Neni 8

Deklarimi

1. Deklarimi i akcizës bëhet nga:

a) depozituesi i miratuar;

b) pritësi i regjistruar;

c) dërguesi i regjistruar;

ç) përfaqësuesi fiskal;

d) individi (personi fizik natyror).

2. Deklarimi bëhet:

a) me shkrim;

b) në mënyrë elektronike, duke përdorur sistemin elektronik;

c) me gojë apo me çdo veprim tjetër, me anë të të cilit mallrat mund t'i nënshtrohen një procedure fiskale vetëm nga personat fizikë natyrorë (individi) për sendet/dërgesat e tyre personale, që janë subjekt i pagesës së akcizës, sipas përcaktimeve në aktet nënligjore, në zbatim të këtij ligji.

Neni 9
Pagesa e akcizës

1. Akciza paguhet:

a) Në nxjerrjen e produkteve të akcizës nga një regjim i pezullimit të detyrimeve, parashikuar në shkronjën "a" të pikës 2 të nenit 4 të këtij ligji nga:

i) depozituesi i miratuar, pritësi i regjistruar ose çdo person tjetër, që kryen nxjerrjen e produkteve që i nënshtrohen akcizës nga një regjim pezullimi i detyrimeve, ose për llogari të të cilit ai e kryen këtë nxjerrje, ose në rastet e nxjerrjes së parregullt nga magazina fiskale nga çdo person tjetër, që ka marrë pjesë në këtë nxjerrje të parregullt;

ii) depozituesi i miratuar, dërguesi i regjistruar ose çdo person tjetër që ka garantuar pagesën e detyrimeve ose nga çdo person që ka pasur dijeni për nxjerrjen e parregullt ose që duhet të ketë qenë në dijeni të nxjerrjes së parregullt, në rastet e parregullsive gjatë një lëvizjeje të produkteve të akcizës nën një regjim pezullues të detyrimeve;

b) Në mbajtjen e produkteve që i nënshtrohen akcizës, sipas shkronjës "b" të pikës 2 të nenit 4 të këtij ligji, nga personi mbajtës i produkteve të akcizës ose çdo person tjetër që ka marrë pjesë në këtë mbajtje.

c) Në prodhimin e mallrave të akcizës, sipas shkronjës "c" të pikës 2 të nenit 4 të këtij ligji, nga personi prodhues i produkteve të akcizës, ndërsa në rastet e prodhimit të parregullt, nga çdo person që ka marrë pjesë në prodhimin e tyre.

ç) Në importimin e produkteve të akcizës, sipas shkronjës "ç" të pikës 2 të nenit 4 të këtij ligji, nga personi që deklaron mallrat e akcizës ose që për llogari të të cilit ato deklarohen në momentin e importit, ndërsa në rastet e importit të parregullt, nga çdo person që ka marrë pjesë në këtë importim.

2. Përveç personave të përmendur në shkronjat "a" deri "ç" të pikës 1 të këtij neni, akciza paguhet edhe nga:

i) blerësi, sipas nenit 6 shkronja "a" të këtij ligji;

ii) blerësi, sipas nenit 6 shkronja "b" të këtij ligji;

iii) shoqëria tregtare e bashkuar, sipas nenit 6 shkronja "c" të këtij ligji;

iv) kreditori, sipas nenit 6 shkronja "ç" të këtij ligji;

v) personi, i cili ka prodhuar, importuar, futur, transportuar, mbajtur, shitur ose blerë produkte akcize në mënyrë të parregullt;

vi) personi, i cili ka marrë pjesë në prodhimin, importin dhe futjen e parregullt të produkteve të akcizës, si dhe personi që mban produkte akcize të prodhuara, të importuara ose të futura në mënyrë të parregullt;

vii) personi, që ka depozituar garanci për pagesën e akcizës sipas këtij ligji ose garantuesi.

viii) përdoruesit e përjashtuar të mallrave të akcizës, kur dërgojnë ose përdorin produkte akcize për qëllime të ndryshme nga ato të përcaktuara në autorizimin e përjashtimit.

3. Kur një ose më shumë persona janë përgjegjës për të njëjtin borxh, që është i lidhur me detyrimin e akcizës, ata janë përgjegjës për shlyerjen e këtij borxhi personalisht dhe/ose bashkërisht.

4. Mënyra dhe format e pagesës se akcizës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, në zbatim të këtij ligji.

Seksioni 2
Përjashtimet, humbjet, firot, *duty free shops*, bagazhet personale

Neni 10

Rastet e përjashtimeve

(shfuqizuar shkronja "dh" e pikës 3, me ligjin nr. 180/2013 datë 28.12.2013)

1. Produktet e akcizës përjashtohen nga pagesa e akcizës kur ato janë të destinuara për t'u përdorur:

a) Për nevoja zyrtare dhe personale, në kuadër të misioneve diplomatike dhe konsullore, përshirë edhe konsujt e nderit, si dhe misionet speciale të akredituara në Shqipëri, për të cilat parashikohet shprehimisht përjashtimi nga pagimi i akcizës.

b) Për nevoja zyrtare dhe personale të organizmave ndërkombëtarë, të njohur si të tillë nga Republika e Shqipërisë e sipas limiteve dhe kushteve të përcaktuara në konventat ndërkombëtare, në bazë të të cilave janë formuar këta organizma, ose në marrëveshjet reciproke.

c) Për forcat e armatosura të çdo vendi anëtar të Traktatit të Atlantikut Verior (NATO), me përjashtim të Forcave të Armatosura të Shqipërisë, për përdorimin nga këto forca ose nga personeli civil që i shoqëron ato për furnizimin e mensave.

ç) Produktet e akcizës të importuara në bagazhin personal të pasagjerëve ose të importuara përmes mjeteve të tjera të transportit ndërkombëtar, sipas limiteve të pataksueshme, parashikuar në legjislacionin doganor.

ç.1) Për produktet e duhanit ,në rastin e importimit për konsum personal, sipas sasive të mëposhtme:

i) 200 cigare;

ii) 100 cigarillo;

iii) 50 puro;

iv) 250 gramë duhan ose përzgjedhje në përpjesëtim të drejtë të këtyre produkteve të ndryshme.

ç.2) Për alkoolin dhe pijet alkoolike, në rastin e importimit për konsum personal, sipas sasive të mëposhtme:

i) 1 litër pije të distiluara dhe alkoole me fortësi alkoolike ndaj volumit më të lartë se 22 për qind, ose alkool etilik i pa denatyruar me forcë alkoolike ndaj volumit 80 për qind dhe më shumë;

ii) 2 litra: pije të distiluara dhe alkoole dhe aperitivë me bazë vere ose alkooli, tafia, sake, ose pije të ngjashme me fortësi alkoolike ndaj volumit që nuk e kalon 22për qind, ose verëra të gazuara, likere, ose një përzgjedhje në përpjesëtim të drejtë të këtyre produkteve të ndryshme;

iii) 2 litra verëra të zakonshme;

iv) 10 litra birrë.

ç.3) Për produkte të tjera, në rastin e importimit për konsum personal, sipas sasive të mëposhtme: 3 kg kafe.

2. Përjashtimet nga akciza, sipas shkronjave "a" e "b" të pikës 1 të këtij neni, nuk mund t'i jepen për nevoja personale qytetarëve shqiptarë ose qytetarëve të huaj që kanë rezidencën e tyre të zakonshme në Shqipëri.

3. Përfitojnë përjashtim nga pagesa e akcizës edhe:

a) produktet e akcizës që eksportohen;

b) mallrat e akcizës që janë vendosur nën regjimin e pezullimit doganor;

c) produktet energjetike me përdorim të dyfishtë. Një produkt është me përdorim të dyfishtë kur është i destinuar njëkohësisht si lëndë djegëse dhe për përdorim të ndryshëm nga ai i karburanteve ose i lëndëve djegëse. Përdorimi i produkteve energjetike për reduktimin kimik dhe elektrolizën, si dhe procese metalurgjike konsiderohen si një përdorim i dyfishtë;

ç) produktet energjetike të përdorura në proceset mineralogjike;

d) karburanti për anijet e peshkimit në sasitë, kushtet dhe kriteret e përcaktuara me vendim

të Këshillit të Ministrave;

dh) *Shfuqizuar*[4].

e) karburanti që përdoret nga avionët e linjave ndërkombëtare për tregti/transport ndërkombëtar, me përjashtim të atyre që përdoren për përdorim privat apo nacional.

4. Kushtet, mënyrat, kufijtë në vlerë e në sasi dhe formalitetet për dhënien e përjashtimit nga detyrimi i akcizës përcaktohen në aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.

5. Produktet e akcizës, objekt i trajtimit në këtë nen, do t'i nënshtrohen lëshimit të një autorizimi përjashtimi. Këshilli i Ministrave përcakton formën dhe përmbajtjen e autorizimit të përjashtimit.

Neni 11

Humbjet dhe firot

1. Humbja është pakësim i pakthyeshëm i produkteve të akcizës të vendosur nën një regjim pezullimi të detyrimeve, për shkak të natyrës së produkteve, për shkak të rrethanave të paparashikuara, forcave madhore ose si pasojë e një autorizimi të dhënë nga autoritetet doganore. Këto lloj humbjesh nuk do të konsiderohen si hedhje për konsum.

2. Për qëllime të këtij ligji, një produkt do të konsiderohet plotësisht i humbur në mënyrë të pakthyeshme, kur ai është bërë i papërdorshëm si produkt akcize.

3. Humbja e pakthyeshme e produkteve të akcizës në fjalë duhet të provohet kundrejt autoriteteve doganore në vendin ku ndodh humbja ose, kur kjo nuk është e mundur, aty ku ajo konstatohet.

4. Firot janë pakësime të pranuara të volumit ose peshës së produkteve të akcizës, të cilat shkaktohen nga vetitë fizike-kimike të produktit, si dhe nga lloji i enëve mbajtëse të produkteve gjatë transportit apo ruajtjes.

5. Këshilli i Ministrave, në zbatim të këtij neni, nxjerr vendim për përcaktimin e humbjeve të pakthyeshme dhe normës së firove.

Neni 12

***Duty free shops* dhe bagazhet personale**

1. Përjashtohen nga pagesa e akcizës mallrat e akcizës që lëvrohen nga *Duty free shops* dhe që merren në bagazhet personale nga udhëtarët që lënë territorin shqiptar në rrugë ajrore dhe detare.

2. Konsiderohen si mallra të lëvruara nga *Duty free shops* edhe mallrat e lëvruara në bordin e avionit gjatë një udhëtimi ndërkombëtar.

3. Për qëllime të këtij neni, me termat e mëposhtëm do të kuptohen:

a) "*Duty free shop*" është çdo ndërtesë e vendosur brenda një aeroporti ose porti që plotëson kushtet e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

b) "Udhëtar që lë territorin shqiptar" është çdo pasagjer i pajisur me një dokument transporti për udhëtim ajror ose detar, ku përcaktohet si destinacion përfundimtar një aeroport ose port jashtë territorit shqiptar.

Seksioni 3

Rimbursimi dhe shuarja e borxhit

[4] Shfuqizimi hyn në fuqi më 1 prill 2014 (neni 14 i ligjit nr. 180/2013).

Neni 13
Kërkesa për rimbursim ose shuarje

Detyrimi i akcizës për produktet e akcizës që janë çliruar për konsum mund të rimbursohet ose të shuhet nga autoritetet doganore kompetente në territorin përkatës, me kërkesë të personit të interesuar, në situatat e përcaktuara, sipas këtij ligji dhe vendimit të Këshillit të Ministrave në zbatim të tij, në përputhje me kushtet e përcaktuara prej tyre, me qëllim shmangien e abuzimeve dhe evazionit të mundshëm.

Neni 14
Rimbursimi
(ndryshuar shkronja "d", me ligjin nr. 142/2014, datë 23.10.2014, nr.140/2015, datë 17.12.2015, shtuar pika 3 me ligjin nr. 140/2015, datë 17.12.2015, ndryshuar shkronja "d" dhe "dh" e pikës 1, me ligjin nr. 126/2016, datë 15.12.2016; shtuar fjalë në pikën 1 shkronja "d"me ligjin nr. 114/2021, datë 25.11.2021)

1. Akciza rimbursohet në rastet e mëposhtme:

a) Kur mallrat e akcizës janë subjekt i një procesi të miratuar nga administrata doganore. Përcaktimet e proceseve të miratuara bëhen me vendim të Këshillit të Ministrave.

b) Kur eksportohen mallra të akcizës, për të cilat akciza është paguar në Shqipëri;

c) Kur sasia e pullave të akcizës të vendosur në mënyrë automatike është prishur dhe kjo sasi bëhet e papërdorshme.

ç) Për lëndët djegëse të përdorura nga subjektet, të cilat ndërtojnë burime të prodhimit të energjisë elektrike, me fuqi të instaluar jo më pak se 5 MW për burim, për nevojat e veta apo për shitje, sipas sasisë, kushteve dhe procedurave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

d) Për lëndët djegëse të konsumuara në serat me ngrohje, për prodhimin e produkteve industriale dhe agroindustriale, të cilat përdoren për nevoja teknologjike të prodhimit të produkteve në këta sektorë, në përputhje me sasitë e produktit final, të shitur me faturë TVSH-je deri më 31 dhjetor 2023 dhe sipas masës, kritereve, kushteve e procedurave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

dh) për biokarburantet që përdoren në sektorin e transportit dhe mishelohen në territorin e Republikës së Shqipërisë për vlerën e detyrimit të akcizës së paguar që i korrespondon masës së produktit "BIO" që gjendet në produktin e deklaruar për konsum pas konfirmimit nga laboratori kimik doganor dhe pas verifikimit prej autoritetit doganor, deri në masën 5%. Procedurat dhe kriteret për rimbursim përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Rimbursimi për sasinë e biokarburanteve kryhet deri në vitin 2020.

2. Subjekt i rimbursimit, sipas pikës 1 të këtij neni, do të jetë depozituesi i miratuar ose dërguesi i regjistruar, në qoftë se aplikojnë pranë zyrës doganore që mbikëqyr aktivitetin për rimbursim, përpara se të bëjë dërgimin e produkteve.

3. Akciza nuk rimbursohet për nënproduktet e naftës të përdorura për nevojat e veta nga subjektet e kërkimit të naftës dhe të vënies në shfrytëzim të zonave naftëmbajtëse, pavarësisht nga destinacioni i përdorimit.

Neni 15
Shuarja e borxhit të akcizës

Borxhi i akcizës shuhet kur:

a) paguhet shuma e detyrimit të akcizës;

b) shuhet shuma e detyrimit të akcizës;

c) mallrat, që i nënshtrohen detyrimit të akcizës, konfiskohen;

ç) mallrat, që i nënshtrohen detyrimit të akcizës, sekuestrohen dhe, në të njëjtën kohë ose më pas, konfiskohen;

d) mallrat, që i nënshtrohen detyrimit të akcizës, asgjësohen nën mbikëqyrjen doganore ose kalojnë në pronësi të shtetit.

Seksioni 4
Klasifikimi fiskal, niveli i detyrimeve, mënyra e llogaritjes

Neni 16
Klasifikimi fiskal

1. Klasifikimi fiskal i mallrave të akcizës bëhet bazuar në tarifën doganore të Republikës së Shqipërisë, duke iu referuar kapitujve e kodeve dhe shënimeve shpjeguese të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave.

2. Dispozitat e këtij ligji, që kanë lidhje me përcaktimet e produkteve të akcizës, do të zbatohen respektivisht në rastet e ndryshimit të kodeve të NK-së, sipas ligjit të tarifës, kur nuk ndryshojnë qëllimin dhe shumën e akcizës.

Neni 17
Kushtet e pagesës dhe niveli i detyrimeve

Kushtet e pagesës dhe niveli i detyrimit të akcizës do të jenë sipas kushteve dhe nivelit që është në fuqi në datën e hedhjes për konsum të produkteve të akcizës, kur:

a) mallrat e akcizës, të prodhuara ose të ambalazhuara në Shqipëri, duhet të kenë të ngjitura pulla akcize me nivel taksimi që është në fuqi ditën kur produkti i akcizës deklarohet për t'u hedhur në qarkullim të lirë për konsum;

b) mallrat e akcizës, të importuara në Shqipëri, duhet të kenë të ngjitura pullat me nivel taksimi që është në fuqi ditën kur mallrat deklarohen në doganë për qarkullim të lirë për konsum.

c) mallrat e akcizës, që kërkojnë pullë, importohen/prodhohen/ambalazhohen në Shqipëri me pulla të ngjitura me nivel taksimi më të ulët sesa ai në fuqi dhe diferenca paguhet përpara çlirimit të mallit.

Neni 18
Mënyra e llogaritjes
(shtuar pika 3 me ligjin nr. 114/2021, datë 25.11.2021

1. Akciza është taksë specifike.

2. Akciza llogaritet bazuar në njësitë matëse, sipas seksioneve respektive dhe sipas shtojcës 1 të këtij ligji.

3. Akciza e llogaritur sipas pikës 2 të këtij neni, indeksohet çdo dy vjet në masën e normës zyrtare të inflacionit për dy vitet paraardhëse shpallur nga INSTAT-i, me përjashtim të duhanit dhe nënprodukteve të tij, për të cilat akciza aplikohet sipas kalendarit specifik të përcaktuar në shtojcën nr. 1 që i bashkëlidhet ligjit.

Përjashtimisht përcaktimit të paragrafit të parë të kësaj pike, për vitin 2022 akciza indeksohet në masën e normës zyrtare të inflacionit të vitit 2020 dhe 9-mujorit të vitit 2021.

KREU III
PRODHIMI, PËRPUNIMI DHE MBAJTJA

Seksioni 5
Dispozita të përgjithshme

Neni 19
Prodhimi, përpunimi dhe mbajtja

Prodhimi, përpunimi dhe mbajtja e mallrave të akcizës në regjimin e pezullimit të detyrimeve kryhen në një magazinë fiskale.

Neni 20
Autorizimi dhe detyrimet e depozituesit të miratuar

1. Magazinat fiskale janë objekt i mbikëqyrjes dhe kontrollit doganor.

2. Autoritetet doganore miratojnë autorizimin për hapjen dhe shfrytëzimin e një magazine fiskale. Depozituesi i miratuar pajiset me një kod fiskal specifik.

3. Depozituesi i miratuar është i detyruar:

a) të japë një garanci, me qëllim që të mbulojë riskun e mundshëm në prodhimin, përpunimin ose mbajtjen e mallrave të akcizës;

b) të mbajë për çdo magazinë fiskale regjistrimet dhe kontabilitetin e stokut dhe të lëvizjes së mallrave të akcizës;

c) të plotësojë kërkesat e autoriteteve doganore për shkëmbim elektronik të të dhënave;

ç) të përmbushë të gjitha kërkesat e vendosura nga administrata doganore, për të mundësuar mbikëqyrjen e magazinës fiskale;

d) t'u mundësojë autoriteteve doganore, me kërkesën më të parë, kontrollin mbi mallrat dhe dokumentet;

dh) t'u sigurojë autoriteteve doganore ambientet e duhura për zyrën doganore, me pajisjet e nevojshme, si dhe të përballojë shpenzimet për funksionimin e tyre;

e) të marrë përsipër shpenzimet për kontrollet e kryera sipas kërkesës së tij jashtë orarit zyrtar të funksionimit të zyrës doganore;

ë) të deklarojë llojin e procesit të prodhimit që do të kryejë dhe kartat teknologjike të prodhimit.

4. Mosrespektimi i rregullave të përcaktuara në pikën 3 të këtij neni sjell si pasojë revokimin e autorizimit.

5. Autorizimi i depozituesit të miratuar pushon së qeni i vlefshëm gjithashtu:

a) në rastin e shpërbërjes të një personi juridik;

b) kur hiqet dorë vullnetarisht nga autorizimi i depozituesit të miratuar;

c) kur autoritetet doganore revokojnë autorizimin.

6. Autoritetet doganore mund të revokojnë një autorizim për depozituesin e miratuar nëse:

a) depozituesi i miratuar nuk plotëson më kushtet e vendosura në autorizimin e depozituesit të miratuar ose nuk siguron sistemin e duhur për monitorimin e stoqeve, ose kur nuk plotëson listat e stoqeve brenda afateve kohore të përcaktuara në autorizimin e depozituesit të miratuar;

b) ai nuk depoziton garancinë e llojit të duhur për pagesën e akcizës ose nuk depoziton një garanci në shumën e nevojshme për të paguar akcizën;

c) nuk ekzistojnë më kushtet për dhënien e një autorizimi për depozitues të miratuar;

ç) autorizimi është lëshuar sipas një informacioni të rremë, të dhënë në keqbesim;

d) depozituesi i miratuar nuk ndreq parregullsitë brenda afateve kohore të vendosura nga autoritetet doganore;

dh) depozituesi është i përfshirë në veprimtari kriminale;

e) depozituesi i shmanget pagesës së akcizës.

ë) autorizimi mund të revokohet edhe në raste të tjera kur konstatohen shkelje të dispozitave të këtij ligji.

7. Ankimi, që mund të bëhet ndaj vendimit për revokimin e autorizimit të depozituesit të miratuar, nuk mund të shtyjë zbatimin e vendimit.

8. Kushtet, mënyrat dhe formalitetet për dhënien e autorizimit, sipas pikës 2 të këtij neni, si dhe afatet e vlefshmërisë së autorizimit përcaktohen në aktet nënligjore, në zbatim të këtij ligji.

KREU IV
BORXHI, GARANCITË

Neni 21
Garantuesi

1. Kur, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, kërkohet dhënia e një garancie, me qëllim që të sigurohet pagesa e një borxhi, kjo garanci depozitohet nga depozituesi i miratuar, dërguesi i regjistruar, pritësi i regjistruar ose nga përfaqësuesi fiskal.

2. Për një borxh, autoritetet doganore mund të kërkojnë vetëm një garanci.

Neni 22
Garancia globale

1. Me kërkesë të depozituesit të miratuar, dërguesit të regjistruar, pritësit të regjistruar/operatorit të regjistruar ose të përfaqësuesit fiskal, autoritetet doganore mund të lejojnë dhënien e një garancie globale për të mbuluar dy ose më shumë veprime, për të cilat ka lindur ose mund të lindë një borxh. Për magazinat fiskale të stokimit garantohet vlera e detyrimit të akcizës për produktin në gjendje stoku, duke u debituar për daljet dhe duke u kredituar për hyrjet.

2. Për magazinat fiskale të prodhimit garantohet vlera mesatare e përllogaritur e një cikli prodhimi, me të drejtë korrektimi periodik. Tipi i garancisë në këtë rast është garanci globale që nuk debitohet apo kreditohet.

3. Qarkullimi nën pezullim i produkteve të gatshme, me destinacion magazinat fiskale të stokimit, bëhet me garanci të veçantë që debitohet në nisje dhe kreditohet në mbërritje. Ky garantim mund të bëhet nga vetë depozituesi i miratuar ose përfaqësuesi i tij (Agjencia doganore).

4. Qarkullimi nën pezullim i lëndëve të para me destinacion magazinat fiskale të prodhimit garantohet nga garancia globale përkatëse, kur nisësi dhe destinuesi i mallit është i njëjtë.

5. Depozituesit e miratuar të lëndëve të para energjetike duhet të garantojnë akcizën mesatare të llogaritur për produktet që prodhohen me këto lëndë të para. Brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Këshilli i Ministrave specifikon kriteret e garancisë globale.

Neni 23
Masa e garancisë

1. Depozituesi i miratuar është i detyruar të depozitojë një garanci deri në masën 100 për qind të detyrimit të akcizës të produkteve të depozituara.

2. Nëse garancia jepet nga subjekte të tjera, shuma e garancisë së dhënë nga depozituesi i miratuar zvogëlohet në të njëjtën shumë.

3. Depozituesit e miratuar, dërguesit e regjistruar, pritësit e regjistruar janë të detyruar të garantojnë në masën 100 për qind detyrimin e akcizës edhe për të gjitha operacionet e tjera me pezullim të detyrimeve të akcizës.

4. Autoriteti doganor ka të drejtë të përjashtojë nga detyrimet e përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni institucionet buxhetore.

Neni 24
Format e garancisë

Garancia mund të jepet në formën e një:

a) depozite në të holla;

b) dorëzanie.

Neni 25
Depozita në të holla

1. Depozita në të holla duhet të bëhet në monedhën zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

2. Konsiderohen të barasvlershme me një depozitë në të holla:

a) dorëzimi i një çeku, pagesa e të cilit garantohet nga institucioni që e ka lëshuar atë, në çdo mënyrë që quhet e pranueshme për autoritetet doganore;

b) dorëzimi i çdo instrumenti tjetër të njohur prej autoriteteve doganore si mënyrë pagese, në bazë të Kodit Doganor.

3. Garancia në formën e një depozite në të holla ose çdo formë pagese e barasvlershme me të jepet në përputhje me dispozitat në fuqi.

Neni 26
Dorëzania

1. Dorëzanësi merr përsipër me shkrim të paguajë personalisht dhe/ose bashkërisht me depozituesin e miratuar, pritësin e regjistruar, dërguesin e regjistruar shumën e borxhit të garantuar që duhet paguar.

2. Dorëzanësi duhet të jetë një person i tretë i vendosur në Republikën e Shqipërisë dhe i pranuar nga autoritetet doganore.

3. Autoritetet doganore mund të refuzojnë miratimin e dorëzanësit ose të llojit të garancisë së propozuar, kur kjo e fundit vlerësohet në bazë të kritereve të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave se nuk siguron pagesën e borxhit brenda afatit të përcaktuar.

Neni 27
Zgjedhja e llojit të garancisë

1. Personi, të cilit i kërkohet sigurimi i garancisë, është i lirë të zgjedhë ndërmjet llojeve të garancive, të parashikuara në nenin 24 të këtij ligji.

2. Në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij, autoritetet

doganore mund të refuzojnë pranimin e llojit të garancisë së propozuar, kur ai është i papajtueshëm me funksionimin e regjimit të produkteve të akcizës. E njëjta procedurë zbatohet edhe për garancinë e propozuar. Autoritetet doganore mund të kërkojnë që lloji i garancisë së zgjedhur të mbahet vetëm për një periudhë të caktuar.

Neni 28
Garancia shtesë

Kur autoritetet doganore gjykojnë se garancia e ofruar nuk siguron ose nuk është më e sigurt ose e mjaftueshme për të siguruar pagesën e një borxhi brenda afatit të caktuar, ato kërkojnë prej depozituesit të miratuar, pritësit të regjistruar, dërguesit të regjistruar ose nga përfaqësuesi fiskal, sipas preferencës së tyre, të sigurojnë një garanci shtesë ose të zëvendësojnë garancinë e mëparshme me një garanci të re.

Neni 29
Çlirimi i garancisë

1. Garancia nuk çlirohet për sa kohë që borxhi, për të cilin kjo garanci është lëshuar, nuk është shlyer ose mund të lindë përsëri. Garancia duhet të çlirohet sapo borxhi shlyhet ose kur nuk mund të lindë përsëri.

2. Kur borxhi shlyhet pjesërisht ose mund të lindë vetëm në lidhje me një pjesë të shumës që është siguruar, me kërkesë të personit të interesuar, çlirohet vetëm pjesa përkatëse e garancisë, me përjashtim të rastit kur shuma në fjalë nuk e justifikon këtë veprim.

KREU V
LËVIZJA E MALLRAVE NËN REGJIMIN E PEZULLIMIT TË DETYRIMEVE

Seksioni 6
Dispozita të përgjithshme

Neni 30
Lëvizja e mallrave të akcizës

1. Mallrat e akcizës mund të lëvizin nën regjimin e pezullimit të detyrimeve brenda territorit:

a) Nga një magazinë fiskale te:

i) një magazinë fiskale;

ii) një zyrë doganore daljeje;

iii) një zonë e lirë ose magazinë e lirë;

iv) pritësi i regjistruar.

b) Nga vendi i importimit në një nga destinacionet e përcaktuara në shkronjën "a" të kësaj pike, kur këto mallra dërgohen nga një dërgues i regjistruar.

2. Për qëllim të këtij neni, me "vend importimi" do të kuptohet vendi ku mallrat janë çliruar për t'u hedhur në qarkullim të lirë, sipas dispozitave përkatëse të Kodit Doganor.

3. Depozituesi i miratuar ose pritësi i regjistruar janë përgjegjës për dorëzimin e dokumentit të marrjes së mallit, sipas nenit 34 të këtij ligji.

Neni 31
Garancia në lëvizje

1. Autoritetet doganore i kërkojnë depozituesit të miratuar ose dërguesit të regjistruar që të paraqesin një garanci gjatë lëvizjes së mallrave në pezullim të detyrimeve të akcizës, me qëllim që të shmanget çdo rrezik i mundshëm.

2. Pa anashkaluar pikën 1 të këtij neni, autoritetet doganore nisëse/dërguese, bazuar në kushtet e përcaktuara prej tyre, mund të lejojnë që garancia e parashikuar në pikën 1 të depozitohet nga transportuesi, pronari i produkteve të akcizës ose së bashku nga dy ose më shumë prej tyre ose një nga personat e parashikuar në pikën 1.

3. Garancia duhet të jetë e vlefshme për të gjithë territorin. Modalitetet e saj përcaktohen në aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 32
Detyrimet e pritësit të regjistruar

1. Pritësi i regjistruar nuk mund të mbajë dhe as të dërgojë mallra akcize nën regjimin e pezullimit të detyrimeve.

2. Pritësi i regjistruar regjistrohet pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe pajiset me një kod fiskal.

3. Pritësi i regjistruar përmbush kërkesat e mëposhtme:

a) mban regjistrimet për produktet e akcizës që trajton;

b) lejon çdo kontroll që u mundëson autoriteteve doganore për t'u siguruar se mallrat realisht kanë mbërritur.

Neni 33
Fillimi dhe mbarimi i lëvizjes

Lëvizja e produkteve të akcizës nën një regjim të pezullimit të detyrimeve fillon dhe mbaron në rastet e parashikuara në nenin 30 të këtij ligji.

Seksioni 7
Procedurat që ndiqen gjatë një lëvizjeje të produkteve të akcizës me pezullim nga detyrimet e akcizës

Neni 34
Dokumenti shoqërues i ngarkesës

1. Pavarësisht nga mundësia e përdorimit të procedurave informatike, sipas nenit 36 të këtij ligji, të gjitha produktet, që i nënshtrohen akcizës, që lëvizin nën një regjim pezullimi të pagesës së detyrimeve brenda vendit, shoqërohen nga një dokument administrativ i hartuar nga dërguesi. Ky dokument mund të jetë ose një dokument administrativ, ose një dokument tregtar. Forma dhe përmbajtja e këtij dokumenti do të përcaktohen në përputhje me procedurat e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Për të identifikuar mallrat dhe për të kryer kontrollin e tyre, paketimi duhet të jetë i numërueshëm dhe produktet të përshkruara qartë, duke përdorur për këtë qëllim dokumentin e

referuar në pikën 1 të këtij neni. Në rast se është e nevojshme, secili konteiner ose kolitë, në pamundësi të plumbosjes së konteinerit, plumboset nga dërguesi.

3. Në rastin kur pritësi nuk është një depozitues i miratuar ose pritës i regjistruar, dokumentit të përmendur në pikën 1 të këtij neni duhet t'i bashkëlidhet një dokument që të vërtetojë se detyrimi i akcizës është paguar.

4. Ky dokument duhet të përmbajë të dhënat e mëposhtme:

a) zyrën doganore të destinacionit;

b) datën dhe referencën e pagesës ose të garancisë së pagesës;

c) vlerën përkatëse të akcizës së paguar.

5. Depozituesi i miratuar duhet të dokumentojë qarkullimin, mbajtjen e lëndëve të para të përdorura për prodhimin ose përpunimin e mallrave që i nënshtrohen akcizës.

Neni 35

Rakordimi

1. Autoritetet doganore informohen nga depozituesi, dërguesi dhe pritësi i regjistruar me anë të dokumentit ose një reference të dokumentit të specifikuar në nenin 34 të këtij ligji. Ky dokument do të hartohet në pesë kopje:

a) një kopje mbahet nga dërguesi i regjistruar;

b) një kopje për pritësin;

c) një kopje për t'u kthyer te dërguesi për rakordim;

ç) një kopje për zyrën doganore të destinacionit;

d) një kopje për zyrën doganore nisëse.

2. Kopja e dokumentit, që i kthehet mbrapsht dërguesit për rakordim, vuloset dhe miratohet nga autoritetet doganore kompetente.

3. Kur produktet që i nënshtrohen akcizës lëvizin nën regjimin e pezullimit të detyrimeve te një depozitues i miratuar ose te dërguesi apo pritësi i regjistruar, një kopje e dokumentit administrativ ose një kopje e dokumentit tregtar kthehet nga pritësi te dërguesi për rakordim brenda 15 ditëve nga data e marrjes së ngarkesës nga pritësi.

4. Kopja, që do të kthehet, duhet të përmbajë detajet e mëposhtme të nevojshme për rakordim:

a) zyrën doganore të destinacionit;

b) datën dhe vendin e marrjes së mallrave;

c) një përshkrim të mallrave të marra në mënyrë që të kontrollohet nëse ngarkesa përputhet me detajet që përmban dokumenti. Nëse të dhënat përputhen, atëherë shtohet shënimi "Ngarkesë e kontrolluar".

5. Lëvizja nën regjimin pezullues, siç përcaktohet në pikën 5 të nenit 2 të këtij ligji, mbyllet përmes njërit prej destinacioneve të mëposhtme:

i) hyrjes së produkteve të akcizës në një magazinë fiskale;

ii) daljes së produkteve të akcizës nga territori shqiptar (eksportit);

iii) hyrjes së produkteve të akcizës në një zonë të lirë ose magazinë të lirë. Rakordimi bëhet pasi dërguesi ka marrë kopjen që kthehet mbrapsht të dokumentit shoqërues administrativ, në të cilin përcaktohen detajet e specifikuara në vendimin e Këshillit të Ministrave.

6. Kur produktet, që i nënshtrohen akcizës e që kanë lëvizur nën regjimin e pezullimit të detyrimeve, siç përcaktohet në pikën 5 të nenit 2 të këtij ligji, eksportohen, ky rakordim bëhet përmes një vërtetimi të përpiluar nga zyra doganore e daljes, ku konfirmohet se produkti është nxjerrë jashtë territorit shqiptar.

7. Nëse nuk mbyllet lëvizja nën regjimin e pezullimit, dërguesi informon menjëherë autoritetet doganore.

8. Forma e dokumentit shoqërues të akcizës përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 36

Dokumenti elektronik

1. Lëvizja e një malli akcize mund të kryhet nën regjimin e pezullimit të detyrimeve vetëm duke qenë i mbuluar edhe nga një dokument administrativ elektronik, siç përcaktohet në pikat 2 dhe 3 të këtij neni.

2. Për qëllime të pikës 1 të këtij neni, dërguesi depoziton pranë autoriteteve doganore një projekt-dokument administrativ elektronik me anë të sistemit informatik.

3. Autoritetet doganore kryejnë verifikime elektronike të të dhënave të paraqitura në draftin e dokumentit administrativ elektronik dhe kur:

a) këto të dhëna nuk janë të vlefshme, dërguesi informohet menjëherë;

b) këto të dhëna janë të vlefshme, autoritetet doganore i vendosin dokumentit një numër unik dhe ia komunikojnë dërguesit.

4. Dërguesi pajis personin që shoqëron produktet e akcizës me një kopje të printuar të dokumentit administrativ elektronik, ku identifikohet qartë numri unik. Ky dokument duhet t'u paraqitet autoriteteve doganore me kërkesën më të parë gjatë gjithë lëvizjes nën regjimin e pezullimit të detyrimeve.

5. Dërguesi mund të anulojë dokumentin administrativ elektronik nëse lëvizja nuk ka filluar sipas nenit 30 të këtij ligji.

6. Gjatë lëvizjes së mallrave nën regjimin e pezullimit të detyrimeve, dërguesi mund të bëjë ndryshimin e destinacionit, duke përdorur sistemin informatik në një destinacion të ri.

7. Procedurat e administrimit dhe rakordimit të dokumentit elektronik të shoqërimit të produkteve të akcizës përcaktohen në aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 37

Mosfunksionimi i sistemit informatik

1. Në rast se sistemi informatik nuk funksionon, dërguesi mund të fillojë lëvizjen e produkteve të akcizës nën regjimin e pezullimit të detyrimeve, me kusht që:

a) mallrat të shoqërohen me dokumentin shoqërues në letër, që përmban të njëjtat të dhëna me dokumentin administrativ elektronik;

b) dërguesi të informojë autoritetet doganore të zyrës nisëse përpara nisjes së dërgesës.

2. Kur sistemi informatik rivihet në funksionim, dërguesi duhet të paraqesë projektin e dokumentit administrativ elektronik, sipas nenit 36 të këtij ligji.

3. Sapo të dhënat e dokumentit administrativ elektronik bëhen të vlefshme, kopja e dokumentit letër ruhet nga dërguesi si kopje rezervë, për qëllime kontabiliteti.

4. Për sa kohë që të dhënat nuk janë bërë të vlefshme në sistem, lëvizja do të konsiderohet e mirëqenë, si lëvizje nën një regjim pezullimi detyrimesh e mbuluar nga dokumenti në letër.

Neni 38

Formati dhe struktura e dokumenteve elektronike

Autoritetet doganore në zbatim të këtij ligji përcaktojnë:

a) formën dhe përmbajtjen e dokumenteve elektronike;
b) rregullat dhe procedurat e shkëmbimit të mesazheve;
c) strukturën e dokumenteve në formatin letër.

Neni 39
Dokumenti administrativ i shoqërimit me detyrime akcize të paguara

1. Depozituesi i miratuar është i detyruar që mallrat e akcizës që dalin nga magazina fiskale me detyrime akcize të paguara t'i shoqërojë me një dokument administrativ shoqërimi me detyrime akcize të paguara, që hartohet elektronikisht, një kopje e printuar e të cilit shoqëron mallin në lëvizje.

2. Autoritetet doganore në zbatim të këtij ligji përcaktojnë formën dhe procedurat e administrimit të dokumentit administrativ të shoqërimit me detyrime akcize të paguara.

Seksioni 8
Pullat fiskale

Neni 40
Statusi i pullave fiskale, vlera e detyrimit, lëvizja

1. Pulla fiskale është dokument me vlerë dhe është monopol shtetëror. Në rastet kur Këshilli i Ministrave vendos të ofrojë me koncesion pjesë apo të gjithë veprimtarinë që lidhet me pullat fiskale, përfshirë edhe kontrollin e tyre, atëherë kontrata koncesionare miratohet nga Kuvendi. Koncesion në kuptim të këtij ligji do të thotë dhënia e së drejtës një shoqërie koncesionare për prodhimin, shpërndarjen, gjurmimin dhe kontrollin e pullave fiskale.

2. Pullat e akcizës vendosen në produktet e akcizës në momentin e hedhjes për konsum, në përputhje me përcaktimet e nenit 4 të këtij ligji. Kodet e sigurisë printohen dhe pullat e akcizës do të aplikohen direkt mbi produktet përkatëse, gjatë prodhimit në linjat plotësisht të automatizuara të mbushjes nga prodhuesit në shkallë të madhe apo nga ata importues të birrës apo pijeve të tjera alkoolike, që janë autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Prodhuesit apo importuesit e tjerë do të aplikojnë pullat e akcizës sipas udhëzimeve të Ministrisë së Financave.

3. Vlera e detyrimit të akcizës garantohet në momentin e blerjes së pullave dhe paguhet në momentin e hedhjes për konsum, në përputhje me përcaktimet e nenit 4 të këtij ligji.

4. Vlera e detyrimit të akcizës mund të paguhet edhe në momentin e blerjes së pullave fiskale.

5. Lëvizja e pullave të akcizës kryhet sipas të njëjtave procedura si dhe mallrat e akcizës.

6. Niveli i akcizës për mallrat me pullë fiskale në import, si dhe për mallrat e prodhuara dhe të hedhura për konsum pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve ligjore aplikohet sipas nivelit të taksimit të akcizës në fuqi, respektivisht në çastin e importimit apo hedhjes për konsum. Në rastet kur akciza për mallrat me pullë fiskale është parapaguar sipas pikës 4 të këtij neni, subjekti detyrohet të paguajë diferencën e detyrimit të papaguar, për efekt të rritjes së nivelit të detyrimit.

Neni 41
Aplikimi i pullave fiskale
(ndryshuar pikat 7 dhe 8 me ligjin nr. 140/2015, datë 17.12.2015 dhe me ligjin nr. 126/2016, datë 15.12.2016, shtuar fjalë në pikën 5 me ligjin nr. 98/2018, datë 3.12.2018; ndryshuar fjalia e dytë dhe në vijim e shkronjës "ç"të pikës 8 me ligjin nr. 114/2021, datë 25.11.2021)

1. Pajisen me pullë akcize produktet e tregtuara në shtojcën 1 (Mallrat e tatueshme me akcizë në Republikën e Shqipërisë), pjesa II (birrë, verë, alkool dhe pije alkoolike) dhe pjesa III (duhani dhe nënproduktet e tij) të këtij ligji, duke përjashtuar birrën e prodhuar në vend, si dhe produkte të tjera të pijeve alkoolike që prodhohen në Shqipëri nga prodhuesit në shkallë të madhe, apo birra dhe produkte të tjera të pijeve alkoolike, të importuara nga importuesit e autorizuar për këtë qëllim nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, kur kërkohet pajisja me kodin e sigurisë, sipas pikës 2 të këtij neni.

2. Prodhuesit në shkallë të madhe, instalimi i pajisjeve për përgatitjen dhe vendosja e kodit të sigurisë nga ana e tyre e kërkesa të tjera dhe procedurat e zbatueshme për aplikimin e kodit të sigurisë përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.

3. Produktet e akcizës, që duhet të pajisen me pullë dhe që kanë destinacion eksportin, mund të kenë pulla fiskale që kërkohen nga shteti importues. Në këtë rast, eksportuesi duhet t'u paraqesë prova autoriteteve doganore që tregojnë se ka tërhequr pullat fiskale të shtetit importues.

4. Pulla fiskale duhet të ngjitet/të stampohet në shishe ose në ambalazh tjetër, në mënyrë të tillë që të jetë e dukshme dhe të griset/bëhet e papërdorshme kur hapet tapa.

5. Pulla e akcizës duhet të ngjitet në paketat e cigareve dhe te duhani i grirë poshtë ambalazhit plastik ose ambalazhit letër që mbështjell paketën në mënyrë të tillë që të jetë e dukshme dhe të griset kur hapet paketa.

6. Pa anashkaluar pikën 4 të këtij neni, në rastet kur ambalazhi origjinal i purove ose cigarillos nuk është prej plastike apo letre, pulla duhet të jetë e ngjitur direkt në paketim, në mënyrë të tillë që të jetë e dukshme dhe të griset kur hapet paketimi.

7. Me përjashtim të lëvizjes në transit dhe mbajtjes nën pezullim në magazinë fiskale stokimi ose magazinë doganore, sipas përcaktimeve në Kodin Doganor, hedhja në konsum, blerja e mbajtja e produkteve të përmendura në pikën 1, të këtij neni, konsiderohen të paligjshme.

8. Pa cenuar dispozitat e këtij ligji dhe dispozitat e Kodit Doganor, të cilat u lejojnë importuesve privatë për të importuar mallra akcize për konsum personal, mallrat e akcizës të importuara, që duhet të pajisen me pullë akcize, sipas dispozitave të këtij ligji, duhet ta kenë pullën e akcizës të vendosur në çastin që importohen.

a) Përjashtohen nga përcaktimet e paragrafit të mësipërm rastet kur:

i) këto mallra akcize futen në një magazinë fiskale stokimi ose magazinë doganore, sipas përcaktimeve në Kodin Doganor;

ii) lëvizin nën një regjim transiti nga zyra doganore e hyrjes drejt një zyre doganore tjetër brenda territorit, me destinacion futjen në një magazinë fiskale stokimi ose magazinë doganore, sipas përcaktimeve në Kodin Doganor.

b) Për rastet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, pulla fiskale duhet të jetë e vendosur përkatësisht në momentin e hedhjes për konsum në dalje nga magazina fiskale e stokimit ose magazinë doganore, sipas përcaktimeve në Kodin Doganor.

c) Pajisja apo vendosja e pullës fiskale nuk mund të kryhet në një magazinë fiskale stokimi ose magazinë doganore, sipas përcaktimeve në Kodin Doganor për produktet e importit, të parashikuara në shtojcën 1 të ligjit "Mallrat e tatueshme me akcizë në Republikën e Shqipërisë", pjesa III, "Duhani dhe nënproduktet e tij", përveç duhanit të grirë.

ç) Operacionet e vendosjes së pullës fiskale në një magazinë fiskale stokimi ose magazinë doganore, sipas përcaktimeve në Kodin Doganor kryhen nën mbikëqyrjen e autoriteteve doganore. Depozituesi i miratuar njofton me shkrim ose në formë elektronike zyrën doganore mbikëqyrëse 72 orë përpara fillimit të vendosjes së pullave. Për të mundësuar mbikëqyrjen e gjithë procesit të vendosjes së pullave, autoritetet doganore mbikëqyrëse i kërkojnë depozituesit të miratuar marrjen e

të gjitha masave për vendosjen dhe funksionimin e rregullt të sistemit të kamerave në ambientet ku kryhet vendosja e pullave dhe paraqitjen e rakordimeve për çdo proces pullosjeje. Autoritetet doganore kompetente, kur e konsiderojnë të nevojshme, sigurojnë prezencën e tyre përgjatë procesit të vendosjes së pullave.

d) Këshilli i Ministrave përcakton mekanizmat specifikë të kontrollit, elementët procedurialë të menaxhimit të pullave me koncesionarin apo prezencës së pullave fiskale të shteteve të tjera, ku do të bëhet eksporti apo distribucioni, procedurën e vendosjes së këtyre pullave të huaja me prezencë të doganës gjatë vendosjes, rakordimin e pullave të huaja, të cilat do të hyjnë me Regjimin e Lejimit të Përkohshëm në Shqipëri.

Neni 42

Pagesa dhe tërheqja e pullave fiskale

1. Çmimi (duke përjashtuar TVSH-në dhe çdo taksë tjetër apo detyrim për pullat e aplikueshme, sipas ligjit në Shqipëri), për çdo pullë fiskale të prodhuar dhe të shpërndarë nga një koncesionar i autorizuar nga Republika e Shqipërisë për të prodhuar, shpërndarë dhe monitoruar pullat fiskale, përcaktohet në tabelën e treguar në shtojcën 2 të këtij ligji.

2. Të gjithë prodhuesit dhe importuesit, të cilëve, sipas ligjit, u kërkohet të aplikojnë pullën fiskale, i paguajnë koncesionarit çmimin e përcaktuar në shtojcën 2 të këtij ligji, në një llogari të specifikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij.

3. Për produktet e akcizës që importohen, në rastin kur Drejtoria e Përgjithshme e Doganave udhëzon koncesionarin të dërgojë pullat e akcizës drejtpërdrejt te furnizuesi i huaj i produkteve, subjekt i akcizës, në një adresë të treguar nga importuesi dhe të miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, importuesit paguajnë, në një llogari të përcaktuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, kostot e dërgesës dhe kostot e lidhura me të (duke përfshirë, por jo vetëm, shpenzimet e lidhura me trajtimin, sigurinë dhe sigurimet etj.).

4. Pagesa e pullave fiskale, si dhe shpenzimet përkatëse, siç përcaktohen në pikat 2 dhe 3 të këtij neni, duhet të parapaguhen.

5. Përcaktimi i modaliteteve teknike për aplikimin e pullave fiskale, duke përfshirë, por jo vetëm, prodhimin dhe shpërndarjen e pullave, shpenzimet për prodhimin e zbatimin e pullave fiskale, të personave të autorizuar për të prodhuar dhe zbatuar dhe karakteristikat e të dhënave që përmbajnë pullat fiskale, si dhe dispozita të tjera, që lidhen me mallrat e akcizës, që duhet t'i aplikohen pullat fiskale, përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.

Neni 43

Rregulla të përgjithshme për pullat fiskale

1. Pullat fiskale i jepen depozituesit të miratuar dhe importuesit të produkteve të akcizës, sipas kërkesës së tyre për të pasur pulla fiskale.

2. Prodhimi dhe shitja e paautorizuar e pullave fiskale konsiderohet e paligjshme.

3. Dëmtimi i paramenduar i pullave fiskale konsiderohet i paligjshëm.

4. Autoritetet doganore mbikëqyrin prodhimin, porositjen, lëvizjen, përdorimin, regjistrimin, kontabilizimin dhe mbajtjen e pullave fiskale.

5. Procedurat e mbikëqyrjes së prodhimit, porositjes, lëvizjes, përdorimit, regjistrimit, kontabilizimit dhe mbajtjes së pullave fiskale përcaktohen përmes akteve nënligjore, në zbatim të

këtij ligji.

KREU VI
KOMPETENCAT E AUTORITETEVE DOGANORE

Neni 44
Atributet dhe kompetencat

1. Punonjësit e autoriteteve doganore që administrojnë këtë ligj kanë atributet e policisë gjyqësore. Detyrat dhe të drejtat e personelit që kryen funksionet e policisë gjyqësore janë të përcaktuara nga legjislacioni specifik për këtë qëllim.

2. Autoritet doganore, në bazë dhe në zbatim të këtij ligji, si dhe për të siguruar mirë administrimin e akcizës, kanë këto kompetenca:

a) Në impiantet e miratuara si magazina fiskale, aparateve ose mekanizmave mund t'u vendosen plumbçe ose stampa, si dhe mund të kërkojnë, me shpenzimet e depozituesit të miratuar, kryerjen e punimeve dhe marrjen e masave të nevojshme për mbrojtjen e interesave fiskalë, përfshirë këtu edhe instalimin e instrumenteve matëse.

b) Pranë këtyre impianteve mund të vendosen zyrat e doganës, me qëllim mbikëqyrjen e administrimit të akcizës.

c) Përfaqësuesit e autoriteteve doganore të pajisur me karta identifikimi kanë të drejtë të kryejnë hetimet dhe kontrollet e nevojshme për të parandaluar, zbuluar dhe ndëshkuar shkeljet e parashikuara në këtë ligj.

3. Përfaqësuesit e autoriteteve doganore mund të hyjnë lirisht në çdo moment në magazinat, në impiantet dhe në ambientet ku prodhohen, përpunohen, mbahen ose përdoren produktet e akcizës, si dhe në ambientet ku ruhen dokumentet kontabël dhe regjistrimet për këto produkte, me qëllim kryerjen e verifikimeve, kontrolleve, inventarëve, inspektimeve, si dhe për të kontrolluar regjistrat dhe dokumentet.

4. Përfaqësuesit e autoriteteve doganore, në rastet e dyshimeve të arsyeshme për tentativë ose kryerjen e ndonjë prej shkeljeve të parashikuara nga ky ligj, mund të sekuestrojnë dokumente, skedarë kompjuterikë ose regjistrat përkatës, si dhe çdo dokumentacion tjetër të nevojshëm, tregtar apo fiskal, të ndodhura në ambientet e përcaktuara në pikën 3 të këtij neni. Procedurat specifike dhe të detajuara që duhen ndjekur nga autoritetet doganore në rastet e sekuestrimit përcaktohen në aktet nënligjore, në zbatim të këtij ligji.

5. Autoritetet doganore kanë të drejtë të marrin pa pagesë mostra të mallrave përmes procesverbaleve përkatëse, si dhe të vendosin mbi to vula ose plumbçet e nevojshme.

6. Autoritetet doganore mbledhin informacion dhe bëjnë hetime për zbatimin korrekt të dispozitave në fushën e akcizave. Për këtë qëllim ato mund:

a) të ftojnë, duke dhënë arsyen, këdo që merr pjesë në aktivitetet industriale ose tregtare që kanë lidhje me produktet e akcizës, përfshirë edhe përdoruesit, që të paraqiten personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesve të tyre për të dhënë informacione, sqarime apo dokumentacion për përpunimin, transportin, magazinimin, blerjen apo përdorimin e produkteve të akcizës;

b) t'u kërkojnë ndërmarrjeve, institucioneve të kreditimit ose administratës postare të japin kopje të dokumentacionit në lidhje me marrëdhënien me klientin;

c) të kërkojnë kopje ose ekstrakte të akteve dhe dokumenteve që gjykohen të nevojshme për hetimet ose kontrollet, të depozituara në çdo zyrë të administratës publike ose te nëpunësit publikë;

ç) të kryejnë kontroll në të gjitha ambientet, përfshirë ato private në çdo orë në rast të dyshimeve të bazuara, me pëlqimin e pronarit ose me urdhër të lëshuar nga gjykata;

d) të kryejnë kontrolle në qarkullim mbi produktet e akcizës, mjetet që i transportojnë ato, si dhe dokumentet shoqëruese. Për qëllime fiskale, ato kanë të drejtë të plumbosin ngarkesën si dhe të kërkojnë marrjen e mostrave.

Neni 45
Kontrolli doganor

1. Autoritetet doganore mund të kryejnë të gjitha kontrollet doganore që i mendojnë si të nevojshme. Kontrollet doganore mund të përqendrohen në veçanti në ekzaminimin e mallrave të akcizës, marrjen e mostrave, verifikimin e të dhënave të deklarimit dhe ekzistencën dhe vërtetësinë e dokumentacionit, shqyrtimin e llogarive të operatorëve ekonomikë, regjistrimeve dhe kontabilitetit dhe të dhëna të tjera, inspektimin e magazinave fiskale dhe ambienteve të prodhimit, mjeteve të transportit, bagazheve dhe mallrave që sjellin apo mbajnë depozituesit e miratuar, prodhuesit e vegjël apo udhëtarët dhe kryerjen e hetimeve zyrtare apo veprimeve të tjera të ngjashme.

2. Kontrollet doganore, përveç kontrolleve të rastësishme, mbështeten kryesisht në analizën e riskut, duke përdorur teknika elektronike të përpunimit të të dhënave, me qëllim identifikimin dhe vlerësimin e riskut dhe përcaktimin e masave kundërvepruese të nevojshme, në bazë të kritereve të hartuara në nivel kombëtar dhe, aty ku janë të disponueshme, në nivel ndërkombëtar. Republika e Shqipërisë harton, ruan dhe zbaton një kornizë të menaxhimit të riskut, duke shfrytëzuar informacionin nga burime të ndryshme të disponueshme dhe përcakton kriteret e vlerësimit të riskut, masat e kontrollit dhe fushat parësore të kontrollit.

3. Kontrollet e mbështetura në këto informacione dhe kritere do të kryhen pa cenuar kontrollet e tjera të kryera, në përputhje me pikat 1 dhe 2 të këtij neni, ose me dispozitat e tjera në fuqi.

4. Autoritetet doganore, në mënyrë që të plotësojnë detyrimet e tyre ligjore, mund të mbledhin, të ruajnë, të analizojnë dhe të përpunojnë të dhënat e personave fizikë ose juridikë, të cilëve u sigurohen, në bazë të një detyrimi ligjor ose vullnetar ose të një kërkese nga autoritetet doganore, ose që janë përftuar nga zbatimi i legjislacionit doganor dhe mbi akcizën e Republikës së Shqipërisë. Ky proces duhet të kryhet sipas dispozitave në fuqi, veçanërisht ato për mbrojtjen e të dhënave.

5. Autoritetet doganore, pa cenuar pikën 2 të këtij neni, miratojnë masat e përcaktuara më poshtë:

a) rregullat e përgjithshme të menaxhimit të riskut;

b) kriteret dhe fushat parësore të kontrollit;

c) analizat dhe informacionin e riskut që mund të shkëmbehen me administratat doganore të vendeve të tjera, sipas marrëveshjeve përkatëse në fuqi.

Neni 46
Bashkëpunimi ndërinstitucional

1. Kur për të njëjtat mallra, përveç kontrolleve doganore që kryhen nga autoritetet doganore, kryhen kontrolle nga autoritete të tjera kompetente, autoritetet doganore, në bashkëpunim të ngushtë me këto autoritete, kur është e mundur, kryejnë kontrollet, në të njëjtin vend e kohë, sikurse kontrollin doganor (një ndalesë, një kontroll/*one-stop-shop*). Autoritetet doganore kanë rolin koordinues për këtë kontroll.

2. Mënyrat dhe format e bashkëpunimit dhe të shkëmbimit të informacionit me institucione dhe agjenci të tjera përcaktohen në aktet nënligjore, në zbatim të këtij ligji.

3. Në kuadër të kontrolleve të përmendura në këtë seksion, autoritetet doganore dhe autoritetet e tjera kompetente, me qëllim që të minimizohet risku dhe të luftohet shmangia, fshehja e të ardhurave apo mashtrimi, shkëmbejnë ndërmjet njëri-tjetrit të dhënat për hyrjen, daljen, transitin, transferimin, magazinimin etj.

Neni 47

Kontrolli *a posteriori*

1. Autoritetet doganore, pas çlirimit të mallrave/hedhjes për konsum, me qëllim që të sigurohen për saktësinë e të dhënave të deklarimit në doganë, mund të kontrollojnë dokumentet tregtare dhe të dhënat që kanë lidhje me operacionet përkatëse për mallrat, objekt kontrolli, ose për operacionet tregtare të mëparshme që kanë lidhje me këto mallra.

2. Këto kontrolle mund të kryhen te deklaruesi ose përfaqësuesi i tij ose te çdo person, që në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në ushtrim të profesionit të tij ka lidhje me këto mallra, ose te çdo person që posedon këto dokumente ose të dhëna në ushtrimin e profesionit të tij. Autoritetet doganore mund të kontrollojnë mallrat nëse ato mund të gjenden.

3. Kur nga inspektimi i kryer sipas pikave 1 ose 2 të këtij neni, konstatohet se dispozitat për akcizat në fjalë janë zbatuar në bazë informacionesh të pasakta e të paplota, autoritetet doganore, përveç zbatimit të sanksioneve të parashikuara në kreun XII "Shkeljet në fushën e akcizës dhe sanksionet" të këtij ligji, marrin, në përputhje me dispozitat në fuqi, masat e nevojshme për llogaritjen e detyrimeve të munguara dhe pasqyrimin dokumentar, duke u mbështetur në informacionin e ri që disponojnë.

Neni 48

Ruajtja e dokumentacionit

(shtuar pika 4 me ligjin nr. 140/2015, datë 17.12.2015)

1. Për qëllime të kontrolleve doganore, personi i interesuar duhet të mbajë dokumentet dhe informacionin e kërkuar, sipas nenit 20 të këtij ligji, në përputhje me afatet e caktuara në ligjin në fuqi për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, nëpërmjet çdo mjeti që mundëson hyrjen/aksesin nga autoritetet doganore dhe të pranueshëm për këto autoritete.

2. Kur një kontroll doganor, në lidhje me një borxh akcize, tregon se kontabiliteti përkatës duhet të korrigjohet dhe personi në fjalë ka qenë i njoftuar për këtë, dokumentet dhe informacioni ruhen për tri vjet përtej afatit të parashikuar në pikën 1 të këtij neni.

3. Pa rënë ndesh me pikën 1 të këtij neni, kur një ankesë është depozituar ose kur ka filluar procedura gjyqësore, dokumentet dhe informacioni duhet të ruhen derisa procedura e ankimit ose procedurat gjyqësore të përfundojnë.

4. Për qëllime mbikëqyrjeje dhe kontrolli, autoritetet doganore i kërkojnë depozituesit të miratuar të instalojë/të vendosë sisteme mbikëqyrëse me video-kamera. Depozituesi i miratuar në këto raste siguron transmetimin dhe ruajtjen e pacenuar të imazheve të regjistruara nga sistemet mbikëqyrëse me video-kamera brenda afateve të përcaktuara nga autoritetet doganore. Në rast se ka filluar procedura hetimore/gjyqësore, këto imazhe ruhen deri në përfundim të procesit hetimor dhe/ose gjyqësor.

Neni 49

Tarifa për kontrolle

1. Autoritetet doganore nuk vendosin tarifa për kryerjen e kontrolleve doganore ose për çdo kërkesë të depozituesit të miratuar ose pritësit apo dërguesit të regjistruar, sipas këtij ligji, gjatë orarit

zyrtar të punës së zyrave doganore. Megjithatë, autoritetet doganore mund të vendosin tarifa ose të kërkojnë mbulimin e shpenzimeve të kryera për shërbime specifike, në veçanti për rastet e mëposhtme:

a) kur kërkohet prania e personelit doganor jashtë orarit zyrtar të punës ose në objekte të tjera nga ato doganore;

b) gjatë ekzaminimit ose marrjes së mostrave të mallrave për qëllime verifikimi ose shkatërrimi të mallrave, ku përfshihen shpenzime të tjera, të ndryshme nga ato që kryhen nga stafi doganor;

c) nëse merren masat e jashtëzakonshme të kontrollit, kur ato janë të nevojshme për shkak të natyrës së mallrave ose për shkak të rrezikut potencial.

2. Tarifat për zbatimin e këtij neni përcaktohen në aktet nënligjore, në zbatim të këtij ligji.

TITULLI II
DISPOZITA SPECIFIKE PËR PRODUKTET E AKCIZËS

KREU VII
PRODUKTET ENERGJETIKE

Neni 50
Përkufizime

1. Në kuptim të këtij ligji, konsiderohen produkte energjetike produktet e mëposhtme:

a) që klasifikohen në kodet e NK 15 07 deri 15 18, kur janë të destinuara të përdoren si lëndë djegëse ose karburant;

b) që klasifikohen në kodet NK 27 01, 27 02 dhe 27 04 deri 27 15;

c) që klasifikohen në kodet NK 29 01 dhe 29 02;

ç) që klasifikohen në kodin NK 29 05 11 00, që nuk janë me origjinë sintetike, kur janë të destinuara të përdoren si lëndë djegëse ose karburant;

d) që klasifikohen në kodin NK 34 03;

dh) që klasifikohen në kodin NK 38 11;

e) që klasifikohen në kodin NK 38 17;

ë) që klasifikohen në kodin NK 38 26 00, kur janë të destinuara të përdoren si lëndë djegëse ose karburant.

2. Produkte energjetike konsiderohen gjithashtu:

a) produkte të tjera me qëllim konsumi, të vëna në shitje me pakicë ose të përdorura si lëndë djegëse për motorë;

b) shtues ose mbushës të lëndës djegëse të motorëve, nëse deklarohen si të tilla;

c) hidrokarbure të tjera të vendosura në shitje me pakicë ose të përdorura për ngrohje, me përjashtim të torfës ose biomasës. Biomasa përfshin një fraksion të një produkti, i cili mund të biodegradohet, mbetje nga bujqësia, duke përfshirë substanca me origjinë nga bimët ose kafshët, nga pylltaria dhe industritë e lidhura me to, si dhe fraksionet biodegraduese të mbetjeve industriale dhe urbane.

3. Çdo produkt i përcaktuar në shkronjat "a", "b" e "c" të pikës 2 të këtij neni dhe çdo produkt tjetër, që përdoret si zëvendësues, mbushësh ose shtues për lëndët djegëse ose karburantet, i nënshtrohet pagesës së akcizës, sipas të njëjtit nivel akcize dhe në bazë të të njëjtave kushte, si për lëndët djegëse ose karburantin, të cilën ka zëvendësuar, mbushur ose shtuar.

Neni 51

Produktet që paguajnë akcizë

(shtuar pika 3 me ligjin nr. 126/2016, datë 15.12.2016; shfuqizuar pika 3 me ligjin nr. 114/2021, datë 25.11.2021)

1. Mallrat e akcizës të këtij seksioni përfshijnë produktet energjetike të përdorura si karburante për motorët, lëndë djegëse.

2. Llojet e produkteve energjetike, sipas pikës 1 të këtij neni, do të përcaktohen sipas Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, si dhe në bazë të karakteristikave të veçanta të çdo produkti.

3. Shfuqizuar.

Neni 52

Baza e llogaritjes së akcizës dhe niveli i akcizës

1. Baza e llogaritjes së akcizës mund të jetë 1000 kg peshë neto ose 1000 litra ose vlerë kalorifike bruto e llogaritur gJ ose metër kub të një produkti të veçantë akcize. Në rastet kur akciza paguhet për litër, matjet bëhen në temperaturën 15° Celcius. Konvertimi i lëngjeve në temperaturën 15° Celcius bëhet sipas tabelave të standardit ASTM.

2. Baza për llogaritjen e akcizës për metanin, gazin natyror dhe hidrokarburet e tjera, të paraqitura në gjendje të gaztë, të destinuara për t'u përdorur si karburante, llogaritet mbi volumin e matur në gjendje të gaztë nën presion 760 milimetër mërkur në temperaturë 0° Celcius dhe e shprehur në 100 m^3 deri me 2 shifra pas presjes dhjetore.

Neni 53

Matja e produkteve energjetike

1. Depozituesit e miratuar duhet të matin hyrjet, daljet dhe stoqet e produkteve energjetike, duke përdorur matës lëngjesh ose peshore dhe pajisje të tjera matëse, të certifikuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, të vendosura me shpenzimet e vetë depozituesit të miratuar dhe të plumbosura edhe nga autoritetet doganore kompetente.

2. Përveç instrumenteve matëse të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, autoritetet doganore duhet të sigurojnë plumbosjen e tubacioneve, rubineteve dhe të gjitha pajisjeve të tjera, që lidhen me matjen e daljeve të produkteve energjetike.

3. Riparimet, zëvendësimet dhe punime të tjera, që kërkojnë heqjen ose vënien ose rivënien e plumbçeve të doganës, mund të kryhen vetëm në praninë e autoriteteve doganore, të cilat mbajnë procesverbal për këtë qëllim.

Neni 54

Ngjyrosja e vajrave të naftës

1. Nënproduktet e naftës, për të mundësuar kontrollin nga autoritetet doganore, si dhe për të shmangur çdo lloj abuzimi të mundshëm, përpara hedhjes për konsum, mund të ngjyrosen dhe të shënjohen me ngjyrues dhe shënjues të miratuar sipas rregullave përkatëse për ngjyrimin, të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për këtë qëllim. Për efekt kontrolli nga administrata doganore, ngjyrosja dhe shënjimi me ngjyrues mund të bëhen edhe për naftën bruto.

2. Substancat ngjyruese nuk duhet të hiqen nga vajrat e naftës, të ngjyrosura sipas pikës 1 të këtij neni, dhe koncentrimi i tyre nuk duhet të ulet, si dhe as të shtohen substanca të tjera, që bëjnë të pamundur për të përcaktuar që vajrat e naftës janë ngjyrosur në mënyrën e duhur.

3. Vajrat e naftës të ngjyrosura dhe të shënjuara duhet të magazinohen në mënyrë të tillë që të sigurohet që produkte të tjera të mos ndikojnë neutralizimin e substancave ngjyruese.

4. Kur depozituesi i miratuar kërkon të bëjë ngjyrosje dhe/ose shënjim, duhet të njoftojë autoritetet doganore me qëllim që të sigurohet mbikëqyrja e kësaj procedure.

5. Procedurat specifike për importimin, hedhjen për konsum, lëvizjen, kontrollin, mbikëqyrjen, ngjyruesit dhe shënjuesit etj. për këto nënprodukte, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, në zbatim të këtij ligji.

Neni 55

Vendi i ngjyrosjes i vajrave të naftës

1. Kur ngjyrosja dhe/ose shënjimi i vajrave të naftës janë kryer përpara importimit, importuesi duhet të paraqesë një certifikatë të lëshuar nga autoritetet kompetente të vendit nisës, në lidhje me llojin dhe sasinë e ngjyruesit dhe/ose shënjuesit të përdorur.

2. Kur ngjyrosja dhe/ose shënjimi nuk është kryer përpara importimit, ngjyrosja dhe/ose shënjimi i vajrave të naftës mund të kryhet vetëm në magazina fiskale nga depozituesi i miratuar, në autorizimin për magazinë të të cilëve përfshihet edhe ngjyrosja dhe/ose shënjimi. Këto magazina duhet të jenë të pajisura me instrumente për dozimin dhe përzierjen ose instrumente të ngjashme që mund të sigurojnë ngjyrosjen dhe/ose shënjimin e rregullt.

3. Në rastet kur vajrat e naftës nuk ngjyrosen dhe/ose shënjohen siç duhet ose kur instrumentet nuk sigurojnë ngjyrosjen dhe/ose shënjimin e duhur, autoritetet doganore revokojnë të drejtën për ngjyrosje dhe/ose shënjim në autorizimin përkatës.

Neni 56

Përdorimi i vajrave të naftës të ngjyrosura

1. Vajrat e naftës të ngjyrosura, sipas nenit 55 të këtij ligji, nuk mund të përdoren dhe të shiten për qëllime të ndryshme përdorimi, për të cilat kanë përfituar përjashtimin apo reduktimin.

2. Depozituesit e miratuar dhe persona të tjerë fizikë që shesin vajra nafte, sipas nenit 55 të këtij ligji, duhet të mbajnë regjistrime të blerësve që përfitojnë përjashtim ose reduktim të detyrimit të akcizës.

3. Vajrat e naftës të ngjyrosura mund të shiten vetëm nga magazina, impiante apo distributorë të miratuar nga autoritetet doganore.

4. Vajrat e naftës të ngjyrosura në serbatorët e mjeteve të transportit, mjeteve lundruese dhe serbatorët e motorëve apo makinerive të tjera, që nuk përfitojnë përjashtim apo reduktim sipas dispozitave të këtij ligji, do të konsiderohen si të ngjyrosura nëse përmbajnë ngjyrues pavarësisht nga përqendrimi.

Neni 57

Magazinat fiskale të produkteve energjetike

1. Rafineritë, stabilimentet e tjera të prodhimit, ku përftohen produkte energjetike që i nënshtrohen akcizës, si dhe magazinat e stokut të produkteve energjetike duhet të marrin statusin e magazinës fiskale.

2. Për kontrollin e prodhimit, përpunimit, lëvizjes dhe përdorimit të produkteve energjetike, administrata doganore mund të kërkojë instalimin e instrumenteve dhe aparaturave për matjen dhe marrjen e mostrave të lëndëve të para dhe të produkteve gjysmë të përfunduara apo të përfunduara, si dhe mund të përshtatë sisteme verifikimi dhe kontrolli që përdorin teknikat informatike.

3. Në ambientet e magazinave fiskale nuk mund të mbahen produkte nafte me detyrime të paguara, përveç atyre që janë të domosdoshme për funksionimin e impianteve, sasia dhe lloji i të cilave përcaktohen nga autoritetet doganore.

4. Autorizimi për administrimin e regjimit të magazinës fiskale të stabilimenteve të prodhimit të produkteve energjetike i revokohet ose nuk i jepet kujtdo që dënohet apo që ka qenë i dënuar me burgim për shkelje në fushën e akcizave.

KREU VIII
ALKOOLI, PIJET ALKOOLIKE

Seksioni 9
Dispozitat e përgjithshme

Neni 58
Fusha e zbatimit dhe përjashtimet

1. I nënshtrohen pagesës së akcizës birra, vera, pijet e fermentuara, ndryshe nga vera dhe produktet alkoolike të ndërmjetme dhe alkooli etilik.

2. Produktet e përmendura në pikën 1 të këtij neni, prodhohen në impiante përpunimi nën regjimin e magazinës fiskale nga depozituesit e miratuar.

3. Autoritetet doganore mund të autorizojnë prodhimin në impiante të ndryshme nga magazinat fiskale me kusht që të përdoren produkte që kanë paguar akcizë dhe kjo akcizë të mos jetë më e ulët se ajo e produktit të përftuar nga përzierja e tyre.

4. Prodhimi nga ana e një privati të produkteve alkoolike të destinuara ekskluzivisht për përdorim vetjak të familjarëve dhe miqve të tij nuk ka nevojë për pajisjen me autorizim, me kusht që prodhimi i përftuar të mos jetë objekt i asnjë aktiviteti shitjeje.

5. Të gjithë përdoruesit e kazanëve të distilimit duhet të deklarojnë dhe të pajisen me autorizim përdorimi pranë autoriteteve doganore kompetente.

Neni 59
Përjashtime nga pagesa

1. Alkoolet dhe pijet alkoolike përjashtohen nga pagesa e akcizës kur janë:

a) të denatyruar me denatyrues të përgjithshëm dhe të destinuar për shitje;

b) të denatyruar me denatyrues special të miratuar nga autoritetet doganore dhe që përdoren në prodhimin e produkteve jo të destinuara për konsum njerëzor ushqimor;

c) të përdorur për prodhimin e uthullës, me kod tarifor NK 22 09;

ç) të përdorur në prodhimin e medikamenteve;

d) të përdorur në një proces prodhimi, me kusht që produkti final të mos përmbajë alkool;

dh) të përdorur në prodhimin e aromave të destinuara për përgatitjen e produkteve ushqimore dhe të pijeve joalkoolike, me një gradë akoolometrike faktike jo më shumë se 1,2 për qind ndaj volumit;

e) të përdorur për mostra për analiza, për provat e prodhimit të nevojshëm ose për qëllime

shkencore;

ë) të përdorur në prodhimin e një përbërësi, i cili nuk është subjekt i akcizës, sipas këtij ligji;

f) të përdorur për qëllime kërkimore ose analiza shkencore;

g) të përdorur për qëllime mjekësore në spitale, qendra mjekësore dhe farmaci.

2. Lehtësitë e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni jepen edhe me anë të rimbursimit të akcizës së paguar.

Neni 60

Magazinat fiskale të alkooleve dhe pijeve alkoolike

1. Regjimi i magazinave fiskale jepet për impiantet, si më poshtë:

a) Në sektorin e alkoolit etilik:

i) stabilimenteve të prodhimit;

ii) punishteve për përmirësimin dhe transformimin e produkteve, për të cilat paguhet akcizë

iii) punishteve për staxhionimin e prodhimeve alkoolike, për të cilat paguhet akcizë;

iv) magazinave doganore me pronësi private, të autorizuara për të mbajtur mallra akcize;

v) magazinave të stabilimenteve dhe punishteve të përmendura në nënndarjet "i" dhe "ii", që ndodhen jashtë këtyre impianteve;

vi) magazinave të tregtarëve të shumicës të produkteve të akcizës;

vii) magazinave të vjetrimit.

b) Në sektorin e prodhimeve alkoolike të ndërmjetme:

i) stabilimenteve të prodhimit;

ii) impianteve të staxhionimit të produkteve të akcizës;

iii) magazinave të tregtarëve të shumicës të produkteve të akcizës.

c) Në sektorin e birrës:

i) fabrikave dhe punishteve të staxhionimit;

ii) magazinave, fabrikave dhe punishteve të staxhionimit që ndodhen jashtë këtyre impianteve;

iii) magazinave të tregtarëve me shumicë të birrës së staxhionuar.

ç) Në sektorin e verës dhe në sektorin e pijeve të fermentuara, të ndryshme nga vera dhe birra:

i) kantinave dhe stabilimenteve të prodhimit;

ii) impianteve të staxhionimit dhe magazinave që kryejnë lëvizje brenda territorit.

2. Garancia e parashikuar në nenin 24 të këtij ligji duhet të jetë e barabartë me shumën e akcizës që paguhet në rast se mallrat do të ishin pajisur me pullë fiskale.

3. Në ambientet e magazinave fiskale nuk mund të mbahen produkte alkoolike me akcizë të paguar.

4. Autorizimi për administrimin e magazinës fiskale në impiantet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni nuk i miratohet ose i revokohet kujtdo që është dënuar për prodhim të paligjshëm ose për evazion të akcizës së alkooleve dhe pijeve alkoolike.

Neni 61

Taksimi i produkteve të alkoolit dhe pijeve alkoolike

Taksimi i alkoolit dhe pijeve alkoolike bëhet në bazë të përqindjes së volumit të alkoolit të pastër (anhidër).

Seksioni 10
Magazinat e produkteve alkoolike që paguajnë akcizë

Neni 62
Objektet e deklarimit

1. Impiantet e transformimit, të staxhionimit, si dhe magazinat e alkoolit dhe të pijeve alkoolike që paguajnë akcizë duhet të deklarojnë veprimtarinë e tyre tek autoritetet doganore kompetente në territorin përkatës.

2. Janë objekt deklarimi, krahas atyre të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, edhe veprimtaritë e shitjes dhe të magazinave të alkoolit të denatyruar me denatyrues të përgjithshëm në sasi mbi 300 litra.

Neni 63
Kushtet për ambalazhimin dhe etiketimin

Produktet alkoolike hidhen në shitje të ambalazhuara në formën që parashikohet në dispozitat përkatëse.

Seksioni 11
Alkooli etilik

Neni 64
Objekti i taksimit

1. Për alkoolin etilik paguhet akcizë me tarifë, bazuar në hektolitrin anhidër të produktit në temperaturë 20° Celcius.

2. Me "alkool etilik" do të kuptohen:

a) të gjitha produktet që kanë një shkallë alkoolometrike efektive mbi 1,2 për qind ndaj volumit dhe që klasifikohen në kodet NK 22 07 dhe 22 08 edhe kur janë pjesë e një produkti të një kapitulli tjetër të NK-së;

b) produktet që kanë një shkallë alkoolometrike efektive mbi 22 për qind ndaj volumit dhe që klasifikohen në kodet NK 2204, 22 05 dhe 22 06;

c) pijet alkoolike që përmbajnë produkte të tretura ose jo.

Neni 65
Përcaktimi i akcizës së alkooleve

1. Në fabrikat e alkoolit etilik prodhimi përcaktohet me anë të përdorimit të matësve të posaçëm, të certifikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, që duhet të instalohen nga depozituesi i miratuar, sipas modaliteteve të përcaktuara nga autoritetet doganore.

2. Sasia e alkoolit etilik që i nënshtrohet akcizës mund të përcaktohet në bazë të kapacitetit prodhues ditor të kazanëve, për punishtet që:

a) janë të pajisura me një aparat të vetëm me zjarr të drejtpërdrejtë, që përbëhet nga një kazan i thjeshtë, i fiksuar në mur ose i fiksuar në mënyrë të qëndrueshme në një furnelë dhe që ka kapacitet jo më shumë se dy hektolitra;

b) nuk prodhojnë më shumë se 3 hektolitra alkool anhidrik në vit.

3. Për fabrikat e përmendura në pikën 2 të këtij neni, alkooli etilik që i nënshtrohet akcizës mund të përcaktohet në bazë të prodhimtarisë për çdo zierje, duke vendosur në aparatin e distilimit një instrument special numërues të zierjeve të kryera.

4. Autoritetet doganore mund të lejojnë që të instalohet direkt me aparatet e distilimit një enë mbledhëse e plumbosur nga autoritetet doganore, ku mblidhet i gjithë alkooli i prodhuar dhe që është përshtatur me pajisjet e duhura për verifikimin e drejtpërdrejtë të produktit.

5. Në rastin e parashikuar në pikën 1 të këtij neni, në përcaktimin e akcizës merret për bazë sasia e produktit të përcaktuar, sipas mënyrës së treguar në pikën 4 të këtij neni, me kusht që të mos jetë më e vogël se 2 për qind, krahasuar me rezultatin e matësit. Në këtë rast, merret si bazë përcaktimi i kësaj të fundit duke i zbritur këtë 2-përqindësh. Në rastet kur matësi është pajisur me një kokë kompensuese të temperaturës, verifikimi kryhet me bazë të vlerës më të madhe ndërmjet sasisë së treguar nga matësi dhe asaj të përcaktuar nga ena e instaluar. Për punishtet e përmendura në pikën 2 të këtij neni merren për bazë sasitë e përcaktuara nga ena e instaluar nëse janë më të mëdha se prodhimtaria e kazanëve.

6. Megjithatë, nëse për sasi të vogla ose nisur nga karakteristika të veçanta të produktit ose për motive të tjera teknike, nuk është i mundur instalimi i matësit, sipas pikës 1 të këtij neni, autoritetet doganore mund të lejojnë që verifikimi të kryhet sipas metodës së parashikuar në pikën 4 të këtij neni.

7. Për kontrollin e prodhimit, autoritetet doganore mund të kërkojnë instalimin e matësve të lëndëve të para alkoolike ose alkooligjene dhe eventualisht të produkteve gjysmë të gatshme që shkojnë për distilim.

Seksioni 12
Rakia

Neni 66
Përkufizime, përjashtime dhe mënyra e taksimit

1. Në kuptim të këtij ligji, me termin "raki" do të kuptohet një pije alkoolike e prodhuar nga rrushi ose nga frutat e fermentuara dhe të distiluara.

2. Emërtimi "raki" përdoret vetëm për pijen alkoolike të prodhuar në mënyrën e përshkruar në pikën 1 të këtij neni dhe që prodhohet në Shqipëri.

3. Nuk i nënshtrohet akcizës rakia e prodhuar nga individët privatë dhe e konsumuar nga vetë prodhuesit, nga familjarët dhe miqtë e tyre, me kusht që të mos jetë objekt i asnjë veprimtarie shitjeje dhe sasia e prodhimit të mos jetë më e madhe se 100 litra në vit.

4. Për rakinë paguhet akcizë me tarifë, bazuar në hektolitrin anhidër të produktit në temperaturë 20° Celcius.

Seksioni 13
Birra

Neni 67
Përkufizime
(ndryshuar me ligjin nr. 180/2013, datë 28.12.2013)

Në kuptim të këtij ligji, me termin "birrë" do të kuptohet:

1. Çdo produkt i kodit 2203 të NK-së, që ka një *shkallë alkoolometrike* ndaj volumit më të

madhe se 0,5 për qind .

2. Çdo produkt që është përzierje e birrës dhe pijeve joalkoolike, që klasifikohet në kodin 2206 të NK-së e që ka një *shkallë alkoolometrike* ndaj volumit më të madhe se 0,5 për qind.

Neni 68
Përcaktime të tjera
(ndryshuar me ligjin nr. 180/2013 datë 28.12.2013)

Akciza e birrës përcaktohet në bazë të hektolitrave për shkallë alkoolometrike të produktit përfundimtar.

Neni 69
Përcaktimi i akcizës së birrës

1. Me qëllim përcaktimin e akcizës së birrës, me produkt të përfunduar kuptohet birra në kushtet kur ajo hidhet për konsum.

2. Për kontrollin e prodhimit instalohen matës të lëndëve të para, të birrës menjëherë mbas staxhionimit dhe eventualisht të produkteve gjysmë të gatshme, si dhe matës për përcaktimin e numrit të ambalazheve të parapërgatitur dhe të mbushur. Me të mbaruar staxhionimi, produkti ruhet në magazinë, regjistrohet në kontabilitet nga depozituesi i miratuar dhe verifikohet nga autoritetet doganore.

3. Staxhionimi i birrës mund të kryhet edhe në fabrika të ndryshme nga ato ku kryhet prodhimi ose në punishte të posaçme ambalazhimi, që, në këtë rast, konsiderohen fabrika birre brenda statusit të magazinës fiskale.

4. Pranohen tolerancat e mëposhtme:

a) dy të dhjetat e gradës alkoolometrike mesatare efektive të produktit të përfunduar, të nxjerrë gjatë kontrolleve të kryera mbi lotet e staxhionuara, për lloje të veçanta ambalazhesh ose konteinerësh.

b) të parashikuara në normativën metrike në fuqi, për vëllimin e ambalazheve të parapërgatitur.

5. Për diferencat përtej kufijve të parashikuar në pikën 4 të këtij neni, bëhet pasqyrimi në kontabilitet, paguhet detyrimi i munguar i akcizës, si dhe aplikohen penalitetet respektive, sipas përcaktimeve të seksionit për shkeljet.

Seksioni 14
Vera

Neni 70
Përkufizime

Në zbatim të këtij ligji, me termat e mëposhtëm do të kuptohen:

1. "Verë e qetë" janë të gjitha produktet që klasifikohen në kodet 22 04 dhe 22 05 të NK, me përjashtim të verërave të shkumbëzuara, të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, që kanë njërën nga karakteristikat e mëposhtme:

a) një shkallë alkoolometrike faktike mbi 1,2 për qind, por jo mbi 15 për qind ndaj volumit, me kusht që alkooli që përmban produkti i gatshëm të jetë përftuar tërësisht nga fermentimi;

b) një shkallë alkoolometrike faktike mbi 15 për qind, por jo mbi 18 për qind ndaj volumit, me kusht që të jetë prodhuar pa u pasuruar dhe që alkooli që përmban produkti i gatshëm të jetë

përftuar tërësisht nga fermentimi.

2. "Verë e shkumbëzuar" janë të gjitha produktet që klasifikohen në kodet 22 04 10, 22 04 21 10, 22 04 29 10 dhe 22 05 të NK-së, të cilat plotësojnë njëkohësisht kushtet e mëposhtme:

a) paraqiten në shishe të mbyllura me tapë në formë kërpudhe, që fiksohet nga kapëse ose tela, dhe që kanë presion të anhidritit karbonik në lëng, të paktën, 3 bar;

b) kanë një shkallë efektive alkoolometrike mbi 1,2 për qind, por jo mbi 15 për qind ndaj volumit, me kusht që alkooli që përmban produkti i gatshëm të jetë përftuar tërësisht nga fermentimi.

Neni 71

Objekti i taksimit dhe mënyra e përcaktimit të akcizës

1. Vera e qetë ose e shkumëzuar i nënshtrohet pagesës së akcizës për hektolitër të produktit të përfunduar.

2. Përjashtohet nga pagesa e akcizës vera e prodhuar nga individët privatë dhe e konsumuar nga vetë prodhuesi, nga familjarët ose miqtë e tij, me kusht që të mos jetë objekt i asnjë veprimtarie shitjeje dhe sasia e prodhimit të mos jetë më e madhe se 200 litra verë në vit.

Seksioni 15

Pije të fermentuara ndryshe nga birra dhe vera

Neni 72

Përkufizime

Në zbatim të këtij ligji, me termat e mëposhtëm do të kuptohen:

1. "Pije të tjera të fermentuara të qeta" janë të gjitha produktet që klasifikohen në kodet 22 04 dhe 22 05 të NK-së, që nuk trajtohen në nenin 70 të këtij ligji, si dhe produktet që klasifikohen në kodin 22 06 të NK-së, përjashtuar pijet e tjera të fermentuara të gazuara, të përcaktuara në shkronjën "b" të kësaj pike, si dhe duke përjashtuar produktet e përmendura në nenin 67 të këtij ligji, që kanë:

a) një shkallë alkoolometrike faktike mbi 1,2 për qind, por jo mbi 10 për qind ndaj volumit;

b) një shkallë alkoolometrike faktike mbi 10 për qind, por jo mbi 15 për qind ndaj volumit, me kusht që alkooli i produktit të jetë përftuar tërësisht nga fermentimi.

2."Pije të tjera të fermentuara të gazuara" janë të gjitha produktet që klasifikohen në kodet 22 06 00 31 dhe 22 06 00 39 të NK-së, si dhe të gjitha produktet e klasifikuara në kodet 22 04 10 dhe 22 04 21 10, 22 04 29 10 dhe 22 05 të NK-së, të patrajtuara nga neni 70 i këtij ligji, të cilat plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) të paraqiten në shishe të mbyllura me tapë në formë kërpudhe, që fiksohet nga kapëse ose tela dhe që kanë presion të anhidritit karbonik në lëng, të paktën, 3 bar;

b) të kenë një shkallë efektive alkoolometrike mbi 1,2 për qind, por jo mbi 13 për qind ndaj volumit;

c) të kenë një shkallë efektive alkoolometrike mbi 13 për qind, por jo mbi 15 për qind ndaj volumit, me kusht që alkooli i produktit të jetë përftuar tërësisht nga fermentimi.

Neni 73

Objekti i taksimit dhe mënyra e përcaktimit të akcizës

1. Pijet e tjera të fermentuara, ndryshe nga birra dhe vera, i nënshtrohen pagesës së akcizës

me të njëjtën tarifë të parashikuar për verën e matur me hektolitër për produkt të gatshëm.

2. Përjashtohen nga pagesa e akcizës pijet e fermentuara, të qeta dhe të gazuara, të prodhuara nga një privat dhe të konsumuara nga vetë prodhuesi, nga familjarët ose miqtë e tij, me kusht që të mos jetë objekt i asnjë veprimtarie shitjeje dhe sasia e prodhimit të mos jetë më e madhe se 200 litra në vit.

3. Produktet e gatshme, si dhe ato, që janë të destinuara për t'u përpunuar në punishte të tjera, ruhen në magazinë, regjistrohen në kontabilitet nga depozituesi i miratuar dhe verifikohen nga autoritetet doganore.

Seksioni 16
Produktet alkoolike të ndërmjetme

Neni 74
Përkufizim

Në zbatim të këtij ligji, me termin e mëposhtëm nënkuptohet:

"Produkte të ndërmjetme" janë të gjitha produktet që klasifikohen në kodet 22 04, 22 05 dhe 22 06 të NK-së, të patrajtuara nga nenet 67, 70 dhe 72 të këtij ligji, që kanë një shkallë alkoolometrike efektive mbi 1,2 për qind të volumit, por nën nivelin e 22 për qind të volumit. Pa rënë ndesh me nenin 72 të këtij ligji, konsiderohet "produkt i ndërmjetëm" çdo pije e fermentuar e qetë, me shkallë alkoolometrike efektive mbi 5,5 për qind të volumit dhe që nuk përftohet tërësisht nga fermentimi, sipas përcaktimit të shkronjës "a" të nenit 72, si dhe çdo pije e fermentuar, e gazuar, me shkallë alkoolometrike efektive mbi 8,5 për qind të volumit dhe që nuk përftohet tërësisht nga fermentimi, sipas përcaktimit të shkronjave "a" e "b" të pikës 2 të nenit 72.

Neni 75
Objekti i taksimit dhe mënyra e përcaktimit të akcizës

1. Produktet alkoolike të ndërmjetme i nënshtrohen pagesës së akcizës me të njëjtën tarifë që ka produkti i gatshëm, i matur në hektolitra.

2. Produktet e gatshme ruhen në magazinë nga depozituesi i miratuar dhe verifikohen nga autoritetet doganore, sipas përcaktimeve në aktet nënligjore, në zbatim të këtij ligji.

KREU IX
KAFEJA
(ndryshuar me ligjin nr. 180/2013 datë 28.12.2013 dhe ndryshuar titulli me ligjin nr. 158/2014, datë 27.11.2014)

Neni 76
Përkufizime
(ndryshuar me ligjin nr. 180/2013 datë 28.12.2013 dhe nr. 158/2014, datë 27.11.2014)

Në kuptim të këtij ligji, me termin "kafe" do të kuptohet:

a) kafeja, nëse është apo jo e pjekur apo e dekafeinizuar, lëvoret dhe lëkurat e kafesë, zëvendësuesit e kafesë që përmbajnë kafe në çdo proporcion, që klasifikohen në kodin 09 01 të NK-së;

b) ekstraktet, esencat dhe koncentratet e kafesë ose përgatitjet që bazohen në kafe dhe zëvendësues të tjerë të kafesë së pjekur, koncentratet dhe përgatitjet prej tyre, që klasifikohen në kodet 21 01 11 00 deri në 21 01 12 98.

Neni 77
Detyrimet
(ndryshuar me ligjin nr. 180/2013 dhe nr. 158/2014, datë 27.11.2014)

1. Akciza për kafenë paguhet duke pasur si njësi matëse 1 kg neto.

2. Akciza për ekstraktet, esencat dhe koncentratet e kafesë ose përgatitjet që bazohen në kafe dhe zëvendësues të tjerë të kafesë së pjekur, koncentratet, përgatitjet prej tyre, paguhet duke pasur si njësi matëse përmbajtjen në kg të kafesë në produktin përfundimtar.

3. Depozituesi i miratuar, pritësi dhe dërguesi i regjistruar janë të detyruar të mbajnë regjistrime për sasitë e kafesë së blerë, shitur, përpunuar, magazinuar, eksportuar, të shprehura në kg neto dhe sipas llojeve.

4. Regjistrimet duhet t'u korrespondojnë të dhënave të deklaratave të importit dhe eksportit, dokumenteve që shoqërojnë lëvizjen, si dhe dokumentacionit tjetër tregtar.

KREU IX/1 PIJET ENERGJIKE
(shtuar me ligjin nr. 158/2014, datë 27.11.2014; shfuqizuar me ligjin nr.108, datë 30.11.2017)

Neni 77/1
Përkufizime
(shtuar me ligjin nr. 158/2014, datë 27.11.2014; shfuqizuar me ligjin nr.108, datë 30.11.2017)

Neni 77/2
Detyrimet
(shtuar me ligjin nr. 158/2014, datë 27.11.2014; shfuqizuar me ligjin nr.108, datë 30.11.2017)

KREU X
PRODUKTET E DUHANIT

Neni 78
Përkufizime
(shtuar pika 6 me ligjin nr. 108, datë 30.11.2017, shtuar pika 8 me ligjin nr. 98/2018, datë 3.12.2018)

1. Produktet e duhanit përfshijnë cigaret, purot, cigarillos, duhanin dhe zëvendësuesit e tij, që klasifikohen në kapitullin 24 të NK-së.

2. Në kuptim të këtij ligji, cigare do të konsiderohen:

a) role të duhanit për t'u tymosur, përveç purove dhe cigarillos, sipas përshkrimeve të këtij ligji;

b) role të duhanit, të cilat, nëpërmjet një procesi të thjeshtë joindustrial, janë vendosur në një mbështjellje prej letre;

c) një role duhani, gjatësia e së cilës, pa pjesën e filtrit dhe të pipëzës, nuk i kalon 9 cm;

ç) në rastet e roleve të duhanit, gjatësia e të cilave, pa pjesën e filtrit ose pipëzës, i kalon 9

cm, copët (sasia në copë) e cigareve përcaktohen duke pjesëtuar gjatësinë e rolesë së duhanit me 9 dhe duke rrumbullakosur shifrën që del në numrin pasardhës të plotë;

d) cigare do të konsiderohen, gjithashtu, edhe produktet që janë bërë, pjesërisht apo tërësisht, prej substancave që nuk janë duhan, por kanë karakteristikat sipas pikës 2 të këtij neni.

3. Në kuptim të këtij neni, puro dhe cigarillos, në qoftë se janë të përshtatshme për tymosje, do të konsiderohen roletë e duhanit, sipas shkronjave "a", "b", "c" dhe "ç" të pikës 2 të këtij neni:

a) që janë bërë tërësisht nga duhan natyral;

b) që janë me një mbështjellje të jashtme prej duhani natyral;

c) që përmbajnë duhan të grirë dhe kanë një mbështjellëse të jashtme dhe një mbështjellëse të brendshme (binder), të dyja nga duhan i riformuar dhe ku mbështjellësja e jashtme ka ngjyrën normale të puros dhe mbështjell të gjithë rolenë, përfshirë filtrin, por jo pipëzën, nëse ka një tillë, me kusht që pesha për njësi, pa përfshirë filtrin dhe pipëzën, nuk i kalon 1,2 gr dhe mbështjellësja e jashtme është në formë spirale me një kënd, të paktën, 30° ndaj aksit gjatësor;

ç) që përmbajnë duhan të grirë dhe kanë një mbështjellëse të jashtme me ngjyrën normale të puros prej duhani të riformuar dhe ku mbështjellësja e jashtme ka ngjyrën normale të puros dhe mbështjell të gjithë rolenë, përfshirë filtrin, por jo pipëzën, nëse ka një tillë, me kusht që pesha për njësi, pa përfshirë filtrin dhe pipëzën, është e barabartë ose kalon 2,3 gr dhe që perimetri i matur, në të paktën 1/3 e gjatësisë, është jo më pak se 34 mm;

d) produktet që pjesërisht përmbajnë substanca të ndryshme nga duhani dhe plotësojnë kushtet, sipas pikës 3 të këtij neni, do të konsiderohen, gjithashtu, puro dhe cigarillos, me kusht që të kenë:

i) mbështjellëse të jashtme prej duhani natyral ose të riformuar;

ii) një mbështjellëse të jashtme dhe një mbështjellëse të brendshme, të dyja prej duhani të riformuar.

4. Në kuptim të këtij ligji, duhan i tymosshëm do të konsiderohen:

a) duhani që ka qenë i prerë ose i ndarë ndryshe, përdredhur ose presuar në blloqe, i përshtatshëm për t'u tymosur pa iu nënshtruar proceseve të tjera industriale;

b) skarcitete ose bëzhdila duhani të përshtatshme për t'u tymosur dhe të vëna në shitje me pakicë, të ndryshme nga produktet, sipas neneve 56 dhe 57 të këtij ligji;

c) duhani i prerë hollë për roletë e cigareve, në të cilin 25 për qind të pjesëzave të duhanit kanë një prerje 1mm apo më shumë;

ç) produktet, të cilat, pjesërisht ose tërësisht, përmbajnë substanca të ndryshme nga duhani dhe plotësojnë kriteret, sipas pikës 1 të këtij neni.

5. Produktet tymosëse që nuk përmbajnë duhan dhe përdoren vetëm për qëllime mjekësore nuk do të konsiderohen produkte duhani, sipas kuptimit të këtij ligji. Produktet e përdorura vetëm për qëllime mjekësore përcaktohen nga Ministria e Shëndetësisë.

6. Nikotinë lëng, që klasifikohet në kodet 3824 99 56 dhe 3824 99 57 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, që përdoret për mbushjen e cigareve elektronike të klasifikuara në kodet e 8543 70 90 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave dhe për krijimin e një procesi tymosjeje.

7. Duhan me ngrohje, klasifikuar me kodin 2403 90 90 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, cilësuar si produkte duhani të riformuara edhe me substanca të tjera, që konsumohet nga një proces ngrohjeje, nëpërmjet një aparati elektronik për ngrohje duhani, të klasifikuar në kodin 8543 70 90, i cili lejon përdoruesin të thithë avujt nga duhani që gjendet në të.

Neni 79

Detyrimet

1. Akciza për cigaret llogaritet për 1000 copë, ndërsa për purot dhe cigarillot për kg.

2. Baza e llogaritjes së akcizës për duhanin e grirë dhe duhanet e tjera të tymosshme do të jetë 1 kg.

Neni 80

Përjashtimet nga akciza

(shtuar pika 3 me ligjin nr. 140/2015, datë 17.12.2015)

1. Nuk paguhet akcizë për produktet e duhanit që janë të destinuara për qëllime shkencore dhe kontrolli cilësie. Akciza e paguar për produktet e duhanit që janë të destinuara për qëllime shkencore dhe kontrolli cilësie është e rimbursueshme.

2. Përdorimi i produkteve të duhanit për qëllimet e mësipërme i nënshtrohet procedurës së dhënies së një autorizimi nga autoritetet doganore.

3. Nuk i nënshtrohet pagesës së akcizës duhani i prodhuar dhe i grirë apo i përpunuar nga individët privatë dhe i konsumuar nga vetë prodhuesit, nga familjarët, për përdorim vetjak, me kusht që të mos jetë objekt i asnjë veprimtarie shitjeje dhe sasia e prodhimit të mos jetë më e madhe se 25 kg në vit.

Neni 80/1

(shtuar me ligjin nr.108, datë 30.11.2017, ndryshuar me ligjin nr. 98/2018, datë 3.12.2018)

Importimi dhe prodhimi i letrës së cigareve në formën e broshurave apo të tubave që përfshihen në kodin 4813 1000, të filtrit të cigares që përfshihet në kodin 4823 dhe 5601 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, kryhet vetëm nga subjektet grumbullues-përpunues të duhanit, të pajisur me linja me cikël të plotë përpunimi dhe paketimi për tregtim, të cilët disponojnë autorizim depozitues i miratuar magazine fiskale prodhimi.

Përveç kushteve të përgjithshme të pajisjes me autorizim magazinë fiskale prodhimi, sipas nenit 20, të ligjit, kushtet specifike, që duhet të përmbushin subjektet përcaktohen me udhëzim nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

TITULLI III

VENDIMET E ADMINISTRATËS DOGANORE, SHKELJET NË FUSHËN E AKCIZËS, VERIFIKIMI I SHKELJEVE, APELIMI

KREU XI

VENDIMET, ANULIMI, REVOKIMI OSE NDRYSHIMI, INFORMACIONI I DETYRUESHËM PËR DETYRIMIN E AKCIZËS

Seksioni 17

Vendime për zbatimin e legjislacionit në fushën e akcizave

Neni 81

Dispozita të përgjithshme

1. Kur një person kërkon që autoritetet doganore të marrin një vendim për një kërkesë të tij

për zbatimin e këtij ligji, duhet të vërë në dispozicion të gjithë informacionin e kërkuar nga këto autoritete, në mënyrë që ato të jenë në gjendje për ta marrë këtë vendim. Në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë ligj, një vendim, gjithashtu, mund të kërkohet nga dhe të merret në lidhje me disa persona.

2. Vendimi i përmendur në pikën 1 të këtij neni do të merret nga autoritetet doganore kompetente, jo më vonë se 45 ditë nga data në të cilën i gjithë informacioni i kërkuar prej tyre është paraqitur, në mënyrë që ato të jenë në gjendje të marrin vendimin. Për vendimin e marrë nga autoritetet doganore, kërkuesi njoftohet pa vonesë.

3. Kur autoritetet doganore nuk janë në gjendje të përmbushin afatet kohore të përcaktuara më lart, ato duhet ta informojnë kërkuesin për këtë fakt para mbarimit të këtyre afateve, duke deklaruar arsyet dhe duke treguar periudhën tjetër kohore, të cilën ato e konsiderojnë të nevojshme për të marrë një vendim lidhur me kërkesën.

4. Përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe në vendim, vendimi i marrë nga autoritetet doganore do të hyjë në fuqi dhe do të jetë i zbatueshëm nga të gjitha palët në datën në të cilën kërkuesi merr zyrtarisht njoftim për vendimin ose konsiderohet sikur ta ketë marrë atë.

5. Para se të marrin një vendim, që do të ndikojë negativisht te kërkuesi, të cilit i është adresuar, autoritetet doganore duhet të komunikojnë arsyet në të cilat ato mbështetin vendimin e tyre. Kërkuesit duhet t'i jepet mundësia për të shprehur pikëpamjet e tij brenda një periudhe 30-ditore, që nga data në të cilën është bërë komunikimi. Pas mbarimit të kësaj periudhe kohore, personi në fjalë duhet të njoftohet për vendimin, në formën e duhur, duke përcaktuar bazat ku është mbështetur. Në vendim duhet të vihet në dukje e drejta për apelim, e parashikuar nga neni 105 i këtij ligji.

6. Pa cenuar dispozitat e përcaktuara në fusha të tjera, që specifikojnë rastet dhe kushtet, në të cilat vendimet janë ose bëhen të pavlefshme, autoritetet doganore, të cilat lëshojnë një vendim, mund në çdo kohë ta anulojnë, ta ndryshojnë ose ta revokojnë atë, kur konstatohet se ai nuk është në përputhje me dispozitat e këtij ligji. Subjekteve, që preken nga ky vendim, u lihet një afat 30-ditor për plotësimin e dokumentacionit apo kërkesave të tjera të ligjit, në mënyrë që të jenë në përputhje me to.

Neni 82

Shfuqizimi i vendimeve të favorshme

1. Autoritetet doganore shfuqizojnë një vendim të marrë në favor të kërkuesit, në qoftë se plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) vendimi ishte lëshuar duke u mbështetur në informacion të pasaktë ose të paplotë;

b) kërkuesi ishte në dijeni ose objektivisht duhej të ishte në dijeni që informacioni i dhënë ishte i pasaktë apo i paplotë;

c) vendimi mund të kishte qenë ndryshe, në qoftë se informacioni do të kishte qenë i saktë dhe i plotë.

2. Kërkuesi duhet të njoftohet për shfuqizimin e vendimit. Në vendim duhet të parashikohet e drejta për apelim.

3. Shfuqizimi duhet të hyjë në fuqi që nga data e miratimit të vendimit, përveçse kur parashikohet ndryshe në vendim, në përputhje me këtë ligj.

4. Kërkuesi mund të ankohet kundër vendimit të shfuqizimit të vendimit të parë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të shfuqizimit. Drejtori i Përgjithshëm i Doganave kthen përgjigje brenda 30 ditëve për pranimin ose jo të ankesës.

Neni 83
Revokimi dhe ndryshimi i vendimeve të favorshme

1. Një vendim i marrë në favor të kërkuesit revokohet ose ndryshohet kur, në raste të tjera nga ato të përmendura në nenin 82 të këtij ligji, një apo më shumë kushte të përcaktuara për lëshimin e tij nuk ishin përmbushur ose nuk përmbushen më kur kërkuesi nuk përmbush detyrimet që rrjedhin nga vendimi në fjalë si dhe në të gjitha rastet e tjera të mosrespektimit të dispozitave të këtij ligji, për të cilat është parashikuar e drejta e revokimit.

2. Kërkuesi, të cilit i adresohet vendimi i ri, sipas pikës 1 të këtij neni, duhet të njoftohet për revokimin ose ndryshimin e tij.

3. Revokimi ose ndryshimi i vendimit është i vlefshëm që nga data e njoftimit dhe ka fuqi vetëm për të ardhmen. Megjithatë, në raste të veçanta, kur e kërkojnë interesat legjitimë të personit, për të cilin ishte adresuar vendimi, autoritetet doganore mund të shtyjnë datën kur hyn në fuqi revokimi ose ndryshimi. Në vendim duhet të vihet në dukje e drejta për apelim.

4. Personi i interesuar mund të ankohet kundër vendimit të revokimit ose ndryshimit të vendimit të parë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave brenda 30 ditëve nga data e njoftimit. Drejtori i Përgjithshëm i Doganave kthen përgjigje brenda 30 ditëve për pranimin ose jo të ankesës.

KREU XII
SHKELJET NË FUSHËN E AKCIZËS DHE SANKSIONET

Neni 84
Zbatimi i sanksioneve

Autoritetet doganore vendosin sanksione për shkeljet në fushën e akcizës, sipas përcaktimeve të këtij ligji. Penalitetet duhet të jenë efektive, proporcionale dhe me qëllim parandalimin e mospërsëritjen e shkeljeve.

Neni 85
Klasifikimi i shkeljeve

1. Shkelje në fushën e akcizës janë:
a) kundërvajtjet administrative;
b) veprat penale.

2. Pagesa e gjobës, që zbatohet për shkeljen në fushën e akcizës, në asnjë rast nuk do të jetë shkak për të përjashtuar shkelësin nga pagimi i detyrimeve të akcizës që duhen paguar për mallrat, objekt i shkeljes.

3. Vendosja e dënimit administrativ, sipas dispozitave të këtij ligji, nuk e ndalon administratën doganore të paraqesë kallëzim penal në prokurori për veprat penale, të parashikuara në Kodin Penal.

Neni 86
Penalitetet
(ndryshuar pika 2 me ligjin nr. 126/2016, datë 15.12.2016, shtuar pika 3 me ligjin nr. 98/2018, datë 3.12.2018)

1. Penalitetet për të gjitha shkeljet e kryera me produktet e akcizës gjatë procedurës së importit, eksportit, tranzitimit rregullohen sipas Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë.

2. Penalitetet për të gjitha shkeljet e kryera me produktet e akcizës gjatë proceseve të prodhimit, depozitimit dhe lëvizjes nën pezullim të detyrimeve të akcizës rregullohen nga ky kre.

3. Penalitetet për të gjitha shkeljet e kryera në qarkullimin e pullave fiskale gjatë proceseve të porositjes dhe lëvizjes së tyre rregullohen nga ky kre.

Neni 87

Shmangia nga verifikimi ose pagimi i akcizës

(ndryshuar me ligjin nr. 142/2014, datë 23.10.2.2014 dhe me ligjin nr. 126/2016, datë 15.12.2016)

1. Pa rënë ndesh me Kodin Penal, kryen kundërvajtje administrative në fushën e akcizës kushdo që:

a) shmang, me çfarëdolloj mjeti apo mënyre, produktet e akcizës nga verifikimi dhe/ose nga pagimi i akcizës;

b) u jep operatorëve, që u nënshtrohen detyrimeve të akcizës, produkte të përjashtuara nga akciza ose me akcizë të reduktuar;

c) kryen operacione përzierjeje të paautorizuara të produkteve të akcizës, prej të cilave përftohet një produkt që i nënshtrohet një akcize më të lartë, krahasuar me akcizën e secilit komponent veçmas;

ç) rigjeneron produkte të denatyruara, me qëllim përdorimin abuziv të tyre dhe shmangien e pagesës së detyrimit të akcizës;

d) mban produkte akcize të denatyruara në kushte të ndryshme nga ato të përcaktuara për të pasur një trajtim të diferencuar;

dh) mban ose përdor produkte të përftuara nga fabrikimi klandestin apo nga përzierje të paautorizuara;

e) mban, tregton ose përdor produkte të denatyruara, të përziera me produkte që i nënshtrohen pagesës së akcizës;

ë) përdor, përzien, shet produkte akcize me përjashtim apo reduktim, për qëllime të ndryshme përdorimi nga ai për të cilin kanë përfituar përjashtim apo reduktim;

f) tregton produkte që i nënshtrohen akcizës, pa dokumentacion fiskal.

2. Shkeljet e referuara në pikën 1, të këtij neni, dënohen:

a) për herën e parë të konstatuar, me gjobë sa 2-fishi i detyrimeve të akcizës që duheshin paguar;

b) për herën e dytë të konstatuar, me gjobë sa 3-fishi i i detyrimeve të akcizës që duheshin paguar;

c) për herën e tretë të konstatuar dhe më pas, me gjobë sa 5-fishi i detyrimeve të akcizës që duheshin paguar dhe revokim i autorizimit për një periudhë dyvjeçare.

Përveç gjobës që zbatohet, mallrat e akcizës të gjetura pa dokumentacion fiskal sekuestrohen. Mallrat çlirohen nga sekuestroja nëse brenda 30 ditëve nga njoftimi i vendimit paguhet i gjithë detyrimi dhe sanksioni përkatës. Nëse nuk plotësohen këto kushte, mallrat konfiskohen dhe administrohen në përputhje me dispozitat e ligjit për kundërvajtjet administrative për të mbuluar detyrimin dhe sanksionin e vendosur ose në pamundësi shkatërrohen. Nëse nga shitja gjenerohen të ardhura, të cilat kalojnë shumën e detyrimit dhe gjobës, teprica shkon në Buxhetin e Shtetit.

3.Gjoba për shkeljet e parashikuara në shkronjën "c", të pikës 1, të këtij neni, llogaritet jo

vetëm për produktet tërësisht të përfunduara, por edhe për ato që mund të përftoheshin nga lëndët e para gjatë përpunimit ose në pritje për t'u përpunuar apo që gjenden në fabrikë ose në ambientet ku është kryer shkelja.

4. Gjoba për shkeljet e parashikuara në shkronjën "ç", të pikës 1, të këtij neni, llogaritet jo vetëm për produktet që janë duke u rigjeneruar ose tërësisht të rigjeneruara, por edhe për produktet e denatyruara, që gjenden në ambientet ku është kryer shkelja.

5.Depozituesit të miratuar, i cili ka kryer për herë të tretë shkeljen e parashikuar në shkronjat "e" dhe "ë", të pikës 1, të këtij neni, i hiqet për dy vjet e drejta për të përfituar nga përjashtimet.

Neni 88

Prodhimi klandestin i produkteve të akcizës

(ndryshuar shkronja "a" e pikës 1, me ligjin nr.142/2014, datë 23.10.2014 dhe nr. 126/2016, datë 15.12.2016, ndryshuar fjalë në shkronjën "a" të pikës 1 me ligjin nr. 98/2018, datë 3.12.2018)

1. Pa rënë ndesh me Kodin Penal, kushdo, që prodhon në mënyrë të padeklaruar dhe të paautorizuar (klandestine) nga autoritetet doganore produkte që i nënshtrohen pagesës së akcizës, dënohet me:

a) gjobë sa 5-fishi i detyrimeve të akcizës që duheshin paguar për këto produkte të akcizës, të prodhuara në mënyrë të padeklaruar dhe të paautorizuar (klandestine). Gjoba, përveç produkteve tërësisht të përfunduara, aplikohet edhe për produktet që mund të përftoheshin nga lëndët e para në përpunim ose në pritje për t'u përpunuar apo që gjenden në mjediset, në fabrikë a në lokalet ku është kryer shkelja;

b) sekuestrim të makinerive, pajisjeve, mjeteve ndihmëse të prodhimit, lëndës së parë, çdo materiali të nevojshëm për prodhimin e këtyre produkteve, si dhe të gjitha produktet e akcizës të gjetura në çdo kohë.

2. Në kuptim të pikës 1, të këtij neni, me prodhim të paautorizuar kuptohet prodhimi i produkteve të akcizës që kryhet në ambiente dhe me pajisje të padeklaruara dhe të pakontrolluara paraprakisht ose të ndërtuara apo të modifikuara, në mënyrë që produkti të shmanget nga verifikimi.

3. Prodhimi i paautorizuar provohet me praninë në të njëjtin ambient ose në ambientet ngjitur të lëndëve të para të nevojshme për përgatitjen e produkteve të akcizës dhe linjave të prodhimit, të nevojshme për prodhimin e produkteve të akcizës.

4. Mallrat çlirohen nga sekuestroja nëse brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit paguhet i gjithë detyrimi dhe sanksioni përkatës. Nëse nuk plotësohen këto kushte, mallrat konfiskohen dhe administrohennë përputhje me dispozitat e ligjit për kundërvajtjet administrative për të mbuluar detyrimin dhe sanksionin e vendosur ose në pamundësi shkatërrohen. Nëse nga shitja gjenerohen të ardhura, të cilat kalojnë shumën e detyrimit dhe gjobës, teprica kalon në Buxhetin e Shtetit.

Neni 88/1

Prodhimi klandestin i duhanit dhe nënprodukteve të tij

(shtuar neni me ligjin nr.180/2013, ndryshuar shkronja "a" e pikës 1, me ligjin nr. 142/2014, datë 23.10.2014 dhe shfuqizuar me ligjin nr. 126/2016, datë 15.12.2016.)

Neni 89

Manipulimi i pajisjeve dhe shenjave

(hequr fjalë në pikën 1, me ligjin nr. 142/2014, datë 23.10.2014 dhe ndryshuar me ligjin nr. 126/2016, datë 15.12.2016)

1. Pa rënë ndesh me Kodin Penal, kryen kundërvajtje administrative kushdo që shmang produktin nga verifikimi:

a) duke hequr, prishur, manipuluar ose bërë të palexueshëm matësit, plumbçet, pullat, markuesit, ngjyruesit, vulat, treguesit e verifikimit ose pajisje të tjera të nevojshme, të kërkuara apo të vendosura nga autoritetet doganore për qëllime verifikimi dhe kontrolli, sipas këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij;

b) duke mbajtur apo përdorur plumbçet, vulat, pullat, markues, ngjyrues, treguesit e verifikimit ose shenja të tjera të manipuluara ose pa autorizim, të cilat përdoren për qëllime verifikimi dhe kontrolli nga autoritetet doganore, sipas këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

2. Shkeljet e referuara në pikën 1, të këtij neni, dënohen si më poshtë:

a) për herën e parë të konstatuar, me gjobë sa 2-fishi i detyrimeve të akcizës të shmangura të produkteve të akcizës, të konvertuara në sasitë përkatëse sipas parashikimeve të këtij ligji;

b) për herën e dytë të konstatuar, me gjobë sa 3-fishi i detyrimeve të akcizës të shmangura të produkteve të akcizës, të konvertuara në sasitë përkatëse, sipas parashikimeve të këtij ligji;

c) për herën e tretë të konstatuar dhe më pas, me gjobë sa 5-fishi i detyrimeve të akcizës të shmangura të produkteve të akcizës, të konvertuara në sasitë përkatëse sipas parashikimeve të këtij ligji.

3. Pavarësisht nëse është përfshirë ose jo në shkeljet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, depozituesi i miratuar, i cili ka për detyrë të marrë masat e duhura për ruajtjen dhe mirëfunksionimin e matësve, pajisjeve pullave dhe shenjave të tjera të sipërpërmendura, dënohet me gjobë 500 000 lekë.

Neni 89/1

Shmangia nga verifikimi dhe nga pagimi i akcizës për duhanin dhe nënproduktet e tij

(shtuar me ligjin nr.180/2013, hequr fjalë në pikën 1 , me ligjin nr. 142/2014, datë 23.10.2014, shfuqizuar me ligjin nr. 126/2016, datë 15.12.2016)

Neni 89/2

Shmangia nga verifikimi dhe nga pagimi i akcizës për kafen dhe pijet energjike

(shtuar me ligjin nr. 180/2013, datë 28.12.2013 dhe shfuqizuar me ligjin nr. 126/2016, datë 15.12.2016)

Neni 90

Teprica ose mangësi në magazinën fiskale dhe në qarkullimin e produkteve që i nënshtro

(hequr fjalë në pikën 1, me ligjin nr. 142/2014, datë 23.10.2014, ndryshuar me ligjin nr. 126/2016, datë 15.12.2016, hequr fjalë në shkronjën "c" të pikës 6 me ligjin nr. 98/2018, datë 3.12.2018)

1. Mangësitë mbi 2 për qind, përveç firove të lejuara, krahasuar me regjistrat kontabël, të konstatuara në magazinat fiskale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë në

masën sa 3-fishi i detyrimeve të akcizës të munguara që duheshin paguar.

2. Në rastin e produkteve të denatyruara, kur mangësitë e konstatuara janë mbi 1 për qind deri në 2 për qind, përveç firove të lejuara, krahasuar me regjistrat kontabël, përveç pagesës së akcizës me tarifën më të lartë të këtij produkti, aplikohet gjobë në masën 200 000 lekë.

3. Në rastin e produkteve të denatyruara, kur mangësitë e konstatuara janë mbi 2 për qind, përveç firove të lejuara, krahasuar me regjistrat kontabël, aplikohet gjobë në masën sa 3-fishi i detyrimeve të akcizës me tarifën më të lartë që duhej paguar, por jo më pak se 200 000 lekë.

4. Nëse konstatohen sasi tepër, krahasuar me regjistrat kontabël dhe nëse sasia tepër nuk kalon 2 për qind të sasisë së raportuar, depozituesi i miratuar gjobitet me 200 000 lekë. Sasia tepër pasqyrohet në regjistrat kontabël.

5. Për teprica në magazinat fiskale, si dhe teprica të produkteve të denatyruara, mbi 2 për qind dhe të pajustifikuara në dokumentacionin përkatës, aplikohet:

a) për herën e parë të konstatuar, gjobë sa 2-fishi i detyrimeve të akcizës që duheshin paguar, por jo më pak se 200 000 lekë;

b) për herën e dytë të konstatuar, me gjobë sa 3-fishi i detyrimeve të akcizës që duheshin paguar, por jo më pak se 200 000 lekë;

c) për herën e tretë të konstatuar dhe më pas, me gjobë sa 5-fishi i detyrimeve të akcizës që duheshin paguar, por jo më pak se 200 000 lekë.

Sasia tepër pasqyrohet në regjistrat kontabël.

6. Për mangësi mbi firot e lejueshme, të konstatuara në mbërritjen e produkteve që transportohen në regjim pezullues, aplikohet një gjobë sa njëfishi i shumës së detyrimit të akcizës që duhej paguar të sasisë mangët. Nëse mangësia, përveç firove të lejuara, është mbi 2 për qind e sasisë totale të produkteve të akcizës, aplikohet gjobë:

a) për herën e parë të konstatuar, sa 2-fishi i detyrimeve të akcizës që duheshin paguar;

b) për herën e dytë të konstatuar, gjobë sa 3-fishi i detyrimeve të akcizës që duheshin paguar;

c) për herën e tretë të konstatuar dhe më pas, gjobë sa 5-fishi i detyrimeve të akcizës që duheshin paguar.

7. Depozituesi i miratuar, të cilit i gjenden produkte akcize ose lëndë të para të paautorizuara, dënohet:

a) për herën e parë të konstatuar, me gjobë sa 2-fishi i detyrimeve të akcizës që duheshin paguar për këto mallra akcize të paautorizuara;

b) për herën e dytë të konstatuar, me gjobë sa 3-fishi i detyrimeve të akcizës që duheshin paguar për këto mallra akcize të paautorizuara;

c) për herën e tretë të konstatuar dhe më pas, me gjobë sa 5-fishi i detyrimeve të akcizës që duheshin paguar për këto mallra akcize të paautorizuara.

Gjoba, përveç produkteve tërësisht të përfunduara, aplikohet edhe për produktet e akcizës që mund të përftoheshin nga lëndët e para të paautorizuara, në përpunim ose në pritje për t'u përpunuar, që gjenden në ambientet e magazinës fiskale.

8. Për diferenca të konstatuara në cilësi ose në sasi të produkteve të destinuara për eksport, që i nënshtrohen akcizës dhe atyre të deklaruara për t'u përjashtuar ose për t'u rimbursuar, aplikohet gjobë sa 5-fishi i detyrimeve të akcizës që duheshin paguar.

9. Për diferenca të konstatuara në cilësi të produkteve që i nënshtrohen akcizës, aplikohet gjobë sa 3-fishi i detyrimeve të akcizës që duheshin paguar.

10. Tepricat ose mangësitë në pulla fiskale, të konstatuara gjatë kontrollit të magazinave fiskale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe ndëshkohen si diferencat në produkte akcize të konvertuara në sasitë përkatëse, sipas parashikimeve të këtij ligji.

11. Për efekt të përllogaritjes së masës së detyrimeve të akcizës për mangësitë apo tepricat në

magazinat e prodhim/stokimit të lëndëve të para për prodhimin e produkteve të akcizës, niveli i akcizës do të llogaritet në masën e produktit me taksimin më të lartë që mund të prodhohet me këto lëndë të para.

12. Në rastet kur lëndët e para janë të garantuara, përllogaritja e detyrimeve të akcizës bëhet sipas shkallës së taksimit, mbi të cilën është llogaritur garancia e tyre.

Neni 91

Teprica ose mangësi në magazinën fiskale dhe në qarkullimin e produkteve që i nënshtrohen akcizës

(shtuar pika 9 me ligjin nr 180/2013, hequr fjalë në pikën 1 , me ligjin nr.1 42/2014, datë 23.10.2014, shfuqizuar me ligjin nr. 126/2016, datë 15.12.2016)

Neni 91/1

Teprica ose mangësi në mjediset e pritësve të regjistruar

(shtuar pika 9 me ligjin nr. 180/2013, hequr fjalë në pikën 3 , me ligjin nr. 142/2014, datë 23.10.2014, ndryshuar pika 3, me ligjin nr. 126/2016, datë 15.12.2016)

1. Mangësitë mbi 2 për qind, përveç firove të lejuara, të konstatuara gjatë kontrollit në mjediset e pritësve të regjistruar, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë.

2. Nëse gjatë kontrollit konstatohen sasi tepër, krahasuar me regjistrin e hyrje-daljeve, dhe nëse sasia tepër nuk kalon 2 për qind të sasisë së raportuar, pritësi i regjistruar gjobitet me 100 000 (njëqind mijë) lekë.

3. Për teprica në mjediset e pritësit të regjistruar mbi 2 për qind dhe të pajustifikuara në dokumentacionin përkatës aplikohet:

a) për herën e parë të konstatuar, gjobë sa 2-fishi i detyrimeve të akcizës që duheshin paguar, por në çdo rast jo më pak se 50 000 lekë;

b) për herën e dytë të konstatuar, gjobë sa 3-fishi i detyrimeve të akcizës që duheshin paguar, por në çdo rast jo më pak se 50 000 lekë;

c) për herën e tretë të konstatuar e më pas, gjobë sa 5-fishi i detyrimeve të akcizës që duheshin paguar, por në çdo rast jo më pak se 50 000 lekë.

Sasia tepër pasqyrohet në regjistrat kontabël.

Neni 92

Shkelja e detyrimit për mbajtjen e regjistrave, të kontabilitetit dhe diferencat

Mosmbajtja apo mosruajta e regjistrimeve/kontabilitetit për periudhën e caktuar, sipas përcaktimeve të këtij ligji, ose mosdhënia e regjistrimeve/kontabilitetit, sipas kërkesës së organeve doganore, dënohet me gjobë në masën 500 000 lekë.

Neni 93

Pengimi dhe moslejimi i ushtrimit të kompetencave të autoriteteve doganore

1. Pengimi dhe moslejimi i ushtrimit të kompetencave nga autoritetet doganore, pavarësisht nga ndjekja penale, dënohet me gjobë në masën 200 000 lekë.

2. Nëse pas kërkesës të autoriteteve doganore për të ndaluar, transportuesi i mallrave të

akcizës (pavarësisht nga lloji i mjetit) kundërshton të ndalojë ose të lejojë që mjeti i transportit të kontrollohet:

a) sanksionohet me një gjobë në masën 200 000 lekë;

b) nuk lejohet të largohet nga automjeti;

c) ndaj tij bëhet kallëzim penal, si dhe ndërmerren të gjitha masat e nevojshme për ndalimin dhe kontrollin e mjetit transportues.

Neni 94

Mbajtja, transportimi ose shitja e mallrave të akcizës pa pullë fiskale

(shtuar shkronja "c" e pikës 1, me ligjin nr. 140/2015, datë 17.12.2015, ndryshuar pika 1 dhe 3 me ligjin nr. 126/2016, datë 15.12.2016)

1. Mbajtja, transportimi ose shitja në çdo lloj mënyre e mallrave, për të cilat kërkohet pajisja me pulla fiskale, pa qenë i pajisur me pullë fiskale, përveç ndjekjes penale, sanksionohet si më poshtë:

a) Gjobë, për herën e parë të konstatuar, sa 2-fishi i detyrimeve të akcizës që duheshin paguar, për herën e dytë të konstatuar, sa 3-fishi i detyrimeve të akcizës që duheshin paguar, dhe për herën e tretë të konstatuar dhe më pas, sa 5-fishi i detyrimeve të akcizës që duheshin paguar.

b) Konfiskim të mallrave të gjetura pa pullë akcize/fiskale.

c) Kur shkelja konstatohet gjatë transportit, mjeti i transportit në të cilin gjenden mallrat në fjalë sekuestrohet. Mjeti i transportit çlirohet nga sekuestroja nëse brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit paguhet i gjithë detyrimi dhe sanksioni përkatës. Nëse nuk plotësohen këto kushte, mjeti i transportit konfiskohet dhe shitet, në përputhje me dispozitat e ligjit për kundërvajtjet administrative, për të mbuluar detyrimin dhe sanksionin e vendosur.

Mjetet e transportit përjashtohen nga sekuestrimi ose sekuestrimi i vendosur revokohet apo anulohet kur, në bazë të provave që disponohen, rezulton se pronari i tyre nuk është i përfshirë në shkeljen në fjalë. Nëse nga shitja gjenerohen të ardhura, të cilat kalojnë shumën e detyrimit dhe gjobës, teprica kalon në Buxhetin e Shtetit.

2. Kur mallrat e akcizës, për të cilat kërkohet pajisja me pullë fiskale, gjenden pa pullë fiskale, pavarësisht nga fakti se për to është paguar akciza ose jo, konfiskohen dhe depozituesi i miratuar, ku janë gjetur këto mallra akcize, dënohet me një gjobë, për herën e parë të konstatuar, sa 2-fishi i detyrimeve të akcizës që duheshin paguar, për herën e dytë të konstatuar, sa 3-fishi i detyrimeve të akcizës që duheshin paguar, dhe për herën e tretë të konstatuar dhe më pas, sa 5-fishi i detyrimeve të akcizës që duheshin paguar.

3. Mallrat e konfiskuara trajtohen në përputhje me ligjin "Për kundërvajtjet administrative", ose në pamundësi shkatërrohen.

Neni 94/1

Shkeljet në qarkullimin e pullave fiskale

(shtuar me ligjin nr. 98/2018, datë 3.12.2018)

Tepricat ose mangësitë në pullat fiskale mbi 2 % të konstatuara gjatë kontrollit të operatorëve ekonomikë, në rastet kur nuk janë depozitues të miratuar, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe ndëshkohen me gjobë sa 3-fishi i detyrimeve të akcizës, që duheshin paguar si për produktet e akcizës të konvertuara në sasitë përkatëse, me përjashtim të rasteve kur diferencat në qarkullimin e pullave fiskale të konstatuara gjatë procesit të lëvizjes, janë rrjedhojë e aksidenteve rrugore, hekurudhore, detare dhe ajrore apo nga forca natyrore të pakontrolluara, të cilat vërtetohen nga organet doganore, policore dhe të prokurorisë.

Neni 95

Mbajtja, transportimi ose shitja e produkteve të akcizës

pa shenjues ose ngjyrues

(ndryshuar me ligjin nr. 126/2016, datë 15.12.2016, ndryshuar fjalë në shkronjën "a" me ligjin nr. 98/2018, datë 3.12.2018)

Mbajtja, hedhja në qarkullim të lirë, tregtimi, eksportimi, importimi, shpërndarja, transportimi, rafinimi ose kryerja e çdo aktiviteti tjetër me produktet që markohen/shenjohen apo ngjyrosen apo që nuk kanë markuesin/shenjuesin apo ngjyruesin në sasinë dhe përqendrimin e duhur dënohen si më poshtë:

a) për herën e parë të konstatuar, me gjobë sa 2-fishi i detyrimeve të akcizës që duhet të paguhet për të gjithë sasinë e produktit të gjendur në depozitë, për herën e dytë të konstatuar me gjobë sa 3-fishi i detyrimeve të akcizës që duhet të paguhet për të gjithë sasinë e produktit të gjendur në depozitë dhe për herën e tretë të konstatuar dhe më pas, me gjobë sa 5-fishi i detyrimeve të akcizës që duhet të paguhen për të gjithë sasinë e produktit të gjendur në depozitë;

b) me sekuestrimin e të gjithë sasisë së produktit të gjendur në depozitë dhe të mjetit të transportit, kur shkelja është verifikuar gjatë këtij procesi. Mjetet e transportit përjashtohen nga sekuestrimi ose sekuestrimi i vendosur revokohet ose anulohet kur, në bazë të provave që disponohen, rezulton se pronari i tyre nuk është përfshirë në shkeljen në fjalë.

Mallrat dhe mjeti i transportit të sekuestruara çlirohen nëse paguhet i gjithë detyrimi dhe sanksioni përkatës dhe më pas mallrat shenjohen ose ngjyrosen në mënyrën e duhur. Nëse nuk plotësohen të gjitha këto kushte, këto mallra dhe mjete konfiskohen dhe shiten në përputhje me dispozitat e ligjit për kundërvajtjet administrative, për të mbuluar detyrimin dhe sanksionin e vendosur ose shkatërrohen në rastet kur nuk plotësojnë standardet për të qarkulluar në Republikën e Shqipërisë. Nëse nga shitja gjenerohen të ardhura, të cilat kalojnë shumën e detyrimit dhe gjobës, teprica shkon në Buxhetin e Shtetit.

Neni 95/1

Mbajtja, transportimi ose shitja e produkteve të akcizës pa shënjues/markues ose ngjyrues

(shtuar me ligjin nr.140/2015, datë 17.12.2015, shfuqizuar me ligjin nr. 126/2016, datë 15.12.2016)

Neni 95/2

Shkeljet për ndërhyrjet në shënjues ose ngjyrues

(shtuar me ligjin nr.140/2015, datë 17.12.2015, shfuqizuar me ligjin nr. 126/2016, datë 15.12.2016)

Neni 96

Parregullsitë në qarkullim

(shtuar një paragraf me ligjin nr. 180/2013 datë 28.12.2013, ndryshuar me ligjin nr. 126/2016, datë 15.12.2016)

Produktet, që i nënshtrohen akcizës, edhe nëse janë të destinuara për përdorim të përjashtuar nga detyrimi i akcizës ose me tarifë të reduktuar, që transportohen pa dokumentacionin përkatës të

akcizës, me dokumentacion të falsifikuar ose të korrigjuar, apo që nuk lejon të identifikohet subjekti që kryen transportin, konsiderohen me prejardhje të paligjshme. Në këto raste, transportuesi dhe dërguesi solidarisht dënohen, për herën e parë të konstatuar, me gjobë sa 2-fishi i detyrimeve të akcizës që duheshin paguar, për herën e dytë të konstatuar, me gjobë sa 3-fishi i detyrimeve të akcizës që duheshin paguar, dhe për herën e tretë të konstatuar dhe më pas, me gjobë sa 5-fishi i detyrimeve të akcizës që duheshin paguar.

Për efekt të përllogaritjes së masës së detyrimeve të akcizës për mangësitë apo tepricat në magazinat e prodhim/stokimit të lëndëve të para për prodhimin e produkteve të akcizës, niveli i akcizës do të llogaritet në masën e produktit me taksimin më të lartë që mund të prodhohet me këto lëndë të para.

Në rastet kur lëndët e para janë të garantuara, përllogaritja e detyrimeve të akcizës bëhet sipas shkallës së taksimit mbi të cilën është llogaritur garancia e tyre.

Neni 96/1

(shtuar me ligjin nr. 180/2013, hequr fjalë me ligjin nr. 142/2014, datë 23.10.2014 dhe ndryshuar me ligjin nr. 126/2016, datë 15.12.2016)

1. Shkeljet, të cilave u referohet shkronja "a", e pikës 1, të nenit 85, të parashikuara shprehimisht në këtë kre, të cilat nuk kanë sjellë mospagim të detyrimeve që duheshin paguar, dënohen me gjobë 50 000 lekë.

2. Kur i njëjti person ka kryer disa kundërvajtje administrative në të njëjtën kohë, çdo shkelje ndëshkohet në veçanti.

3. Shkelja e mbetur në tentativë ndëshkohet si shkelje e kryer.

Seksioni 18
Verifikimi i shkeljeve në fushën e akcizës

Neni 97

Verifikimi

1. Shkeljet e parashikuara nga ky ligj verifikohen dhe ndëshkohen nga autoritetet doganore kompetente, në përputhje me dispozitat e këtij ligji. Në rastet e evidentimit dhe verifikimit të veprave penale, autoritetet doganore, krahas ushtrimit të kompetencave të tyre për vjeljen e borxhit të akcizës dhe vendosjes së sanksioneve administrative, sipas këtij ligji, bashkëpunojnë me autoritetet gjyqësore kompetente.

2. Për qëllime të këtij kreu, "autoritete doganore kompetente" do të thotë autoritetet doganore që ushtrojnë mbikëqyrje dhe kontrolle në zonën ku është kryer dhe verifikuar shkelja e akcizës apo në zonën ku ajo është kompetente në një territor të caktuar.

3. Për të gjitha shkeljet e dispozitave të këtij ligji dhe akteve nënligjore të tij mbahet një procesverbal me shkrim, i cili duhet të nënshkruhet nga punonjësit doganorë, që kryejnë verifikimin dhe kontrollin, si dhe shkelësi, kur shkelja është evidentuar në prani të tij.

4. Në rast se konstatimi i shkeljes, sipas këtij ligji, bëhet *a posteriori* nga strukturat doganore kompetente ose nga struktura të tjera hierarkike doganore apo të kontrollit, sipas legjislacionit në fuqi, kopja e procesverbalit të nënshkruar nga punonjësit doganorë apo përfaqësuesit e strukturave kontrolluese, që ushtruan verifikimin dhe kontrollin, i njoftohet shkelësit nga autoriteti doganor kompetent brenda 5 ditëve kalendarike. Në procesverbal përcaktohet edhe e drejta e shkelësit për të

paraqitur pretendimet e tij me shkrim, brenda 5 ditëve kalendarike, pranë autoriteteve doganore kompetente.

Neni 98
Forma e procesverbalit

1. Procesverbali duhet të përmbajë:
a) vendin, datën dhe kohën kur verifikohet shkelja;
b) emrat e personave që nënshkruajnë dhe autoritetin që përfaqësojnë;
c) të dhëna identifikuese të depozituesit të miratuar, pritësit apo dërguesit të regjistruar etj., që kanë kryer shkeljen;
ç) llojin e shkeljes së kryer;
d) mënyrën në të cilën është kryer shkelja;
dh) identifikimin e mjetit të transportit;

e) treguesit që lidhen me sasinë, llojin, klasifikimin fiskal të mallrave të akcizës, që janë objekt i shkeljes;
ë) treguesit që lidhen me sekuestrimin/konfiskimin e mundshëm të mallrave të akcizës;
f) shumën e detyrimeve fiskale që duhen paguar;
g) nenet e shkelura, nenet në bazë të të cilave përcaktohen sanksionet, si dhe sanksionet e parashikuara për çdo shkelje;
gj) nënshkrimin e punonjësve të doganës apo strukturave kontrolluese dhe, kur është i pranishëm, nënshkrimin e shkelësit.
2. Autoritetet doganore, në rast të konstatimit të konsumimit të veprave penale, mund të marrin në pyetje shkelësin dhe/apo dëshmitarët. Për këtë qëllim autoritetet doganore duhet t'u bëjnë atyre një njoftim, në të cilin përcaktohet data dhe ora në të cilën duhet të paraqiten personalisht, ose duhet të depozitojnë një dëshmi me shkrim. Afati kohor për t'u paraqitur për këtë qëllim nuk mund të jetë më shumë se 10 ditë. Në rastet e flagrancës marrja në pyetje e shkelësve dhe dëshmitarëve bëhet menjëherë. Konsiderohen, gjithashtu, dëshmitarë të gjithë ata persona që mund të jenë bashkëpunëtorë në shkelje, si dhe vetë punonjësi ose nëpunësi i doganës që ka verifikuar shkeljen dhe ka nënshkruar procesverbalin.
3. Në rastet kur shkelësi dhe dëshmitarët marrin pjesë personalisht në marrjen në pyetje, dy punonjës të autorizuar të doganës drejtojnë seancën dhe përgatitin raportin përkatës.
4. Dëshmitë duhet të nënshkruhen nga i akuzuari, nga dëshmitarët, kur janë të pranishëm, dhe nga të dy punonjësit e doganës që kanë drejtuar marrjen në pyetje.
5. Kur një ose me shumë të akuzuar ose dëshmitarë janë shtetas të huaj, marrja në pyetje bëhet në prani të një përkthyesi, në përputhje me dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Penale dhe të Kodit të Procedurës Civile.

Neni 99
Marrja e vendimit dhe njoftimi

1. Autoritetet doganore, për shkeljen e konstatuar, përgatitin dosjen e plotë në lidhje me shkeljen e verifikuar dhe marrin vendimin përkatës.
2. Vendimi i autoriteteve doganore kompetente për pagimin e detyrimit të akcizës dhe/ose të sanksioneve përkatëse, të përcaktuara në këtë ligj, duhet të merret brenda 10 ditëve nga data e njoftimit me shkrim të procesverbalit të konstatimit të shkeljes. Shuma e detyrimeve, sipas këtij

vendimi, kontabilizohet dhe vendimi i njoftohet shkelësit brenda 5 ditëve.

Neni 100
Kalimi i dosjes tek autoritetet gjyqësore

1. Kur shkelja e konstatuar përbën vepër penale, kallëzimi penal bashkë me dosjen përkatëse, të përmendur në pikën 1 të nenit 99 të këtij ligji, u transferohet autoriteteve gjyqësore kompetente për procedimin penal të mëtejshëm, brenda 72 orëve nga çasti i verifikimit të shkeljes.

2. Materialit kallëzues i bashkëlidhet edhe vendimi për aplikimin e sanksioneve administrative.

Neni 101
Kontabilizimi i borxhit të akcizës dhe kamatëvonesat

Kontabilizimi i borxhit të akcizës, si dhe përllogaritja e kamatëvonesave bëhen sipas përcaktimeve specifike të Kodit Doganor për këtë qëllim.

Neni 102
Parashkrimi i borxhit të akcizës

1. Asnjë borxh doganor nuk do t'i njoftohet debitorit pas përfundimit të një periudhe prej pesë vjetësh, nga data në të cilën është krijuar ky borxh doganor.

2. Kur borxhi doganor është krijuar si rezultat i një veprimi, i cili, në kohën që është kryer, mund të kishte shkaktuar ngritjen e një çështjeje penale dhe/ose gjyqësore, periudha prej pesë vjetësh, e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, zgjatet në 10 vjet.

3. Kur pranë autoriteteve doganore depozitohet një kërkesë ankimore, në përputhje me nenet 108 e 109 të këtij ligji, periudhat e përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni ndërpriten gjatë kohës së ankimit, duke filluar nga data në të cilën është depozituar kërkesa ankimore.

Neni 103
Rikuperimi me forcë i borxhit të akcizës

1. Kur shuma e detyrimeve të akcizës, që duhen paguar, nuk është shlyer brenda afateve të përcaktuara:

a) autoritetet doganore përdorin të gjitha mjetet ligjore për të siguruar pagesën e shumës së borxhit të akcizës;

b) përveç shumës së detyrimeve të akcizës ngarkohen edhe kamatëvonesat. Norma e kamatëvonesave është sa norma e interesit të aplikuar nga bankat e nivelit të dytë, sipas publikimit të bërë nga Banka e Shqipërisë.

2. Autoritetet doganore, kur lind një borxh akcize, me qëllim që të sigurojnë pagimin e këtij borxhi, mund të marrin masat e mëposhtme:

a) sekuestrimin e vlerave monetare, të kredive, sendeve me vlerë të çmuar, dokumenteve, me anë të të cilave bëhen pagesa, valutave të huaja të depozituara në një bankë, që i përkasin debitorit ose garantuesit/ve;

b) sekuestrimin e mallrave, të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, që i përkasin debitorit ose garantuesit/ve, i cili/të cilët ka/kanë detyrime kundrejt debitorit.

3. Autoritetet doganore, përveç ushtrimit të kompetencave të tyre, sipas këtij ligji, mund t'u

kërkojnë autoriteteve kompetente edhe marrjen e masave të tjera specifike, si pezullimi i veprimtarive ekonomike të debitorit ose të veprimtarive të tjera prodhuese, për ushtrimin e të cilave debitori është regjistruar pranë këtyre autoriteteve.

4. Vendimet e marra nga administrata doganore për zbatimin e masave garantuese dhe/ose për rikuperimin me forcë të borxhit të akcizës bëhen tituj ekzekutivë menjëherë sapo ato i njoftohen debitorit.

5. Ekzekutimi i titujve ekzekutivë të nxjerrë nga administrata doganore, menjëherë sapo mbështeten me urdhrin e ekzekutimit të nxjerrë nga autoritetet gjyqësore kompetente, bëhet në bazë të dispozitave të parashikuara nga nenet 511 e në vazhdim të Kodit të Procedurës Civile. Ekzekutimi mund të bëhet edhe nga strukturat e mbledhjes me forcë të detyrimit pranë administratës doganore.

6. Pas aplikimit të masave të parashikuara në pikën 2 shkronjat "a" dhe "b" të këtij neni, autoritetet doganore procedojnë me konfiskimin e tyre, në përputhje me dispozitat e ligjit për kundërvajtjet administrative.

7. Mallrat e konfiskuara shkatërrohen ose administrohen sipas legjislacionit në fuqi.

Seksioni 19
Apelimi

Neni 104
E drejta e apelimit

1. Çdo person ka të drejtë të apelojë kundër çdo vendimi të marrë nga autoritetet doganore për vendosjen e sanksioneve në lidhje me zbatimin e këtij ligji.

2. E drejta e apelimit mund të ushtrohet fillimisht përpara autoriteteve doganore kompetente të caktuara për këtë qëllim e, më pas, përpara autoriteteve gjyqësore, sipas dispozitave në fuqi.

Neni 105
Apelimi ndaj vendimit të autoriteteve doganore për vendosjen e sanksioneve

1. Kundër vendimit të autoriteteve doganore kompetente, shkelësi mund t'i paraqesë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave një ankesë të arsyetuar kundër këtij vendimi brenda 30 ditëve nga data e njoftimit.

2. Për të paraqitur ankesën, apeluesi duhet të paguajë shumën e përgjithshme të detyrimit të akcizës, si dhe të garantojë për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave shumën e përgjithshme të sanksioneve të aplikuara për shkeljen, objekt konflikti.

3. Apeluesi duhet të bashkëshoqërojë ankimin me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për shqyrtimin e ankimit të tij.

4. Drejtori i Përgjithshëm i Doganave merr një vendim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së ankesës dhe ky vendim u njoftohet menjëherë apeluesit dhe autoriteteve doganore kompetente.

5. Nëse ankesa nuk pranohet, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave bën kalimin e menjëhershëm të shumës së garancisë në llogarinë e saj. Nëse kërkesa pranohet, autoritetet doganore duhet t'i kthejnë ankuesit shumën e depozituar të detyrimit të akcizës, si dhe të lirojnë garancinë.

6. Kundër vendimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, apeluesi mund të ankohet pranë autoriteteve gjyqësore brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të mospranimit të ankesës.

7. Në rast se autoritetet gjyqësore pranojnë ankesën, autoritetet doganore duhet t'i kthejnë apeluesit shumën e depozituar. Kthimi i kësaj shume mund të bëhet vetëm pasi vendimi i autoriteteve gjyqësore kompetente merr formë të prerë.

8. Në rast se shkelësi nuk paguan shumën e detyrimit të akcizës, si dhe të penaliteteve të vendosura dhe nuk apelon pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, autoritetet doganore marrin të gjitha masat për të proceduar me vjeljen e shumës së borxhit të akcizës dhe vendosjen e sanksioneve përkatëse, në bazë të procedurave të përcaktuara në këtë ligj për rikuperimin me forcë të borxhit të akcizës.

Neni 106
Pezullimi i zbatimit të vendimit

1. Apelimi ndaj vendimit të autoriteteve doganore kompetente për vendosjen e sanksioneve nuk shkakton pezullimin e zbatimit të vendimit në konflikt.

2. Autoritetet doganore mund të pezullojnë zbatimin e një vendimi të tillë, tërësisht ose pjesërisht, kur ato kanë arsye të besojnë se vendimi në konflikt është i papajtueshëm me legjislacioni doganor, ose sjell një dëm të pariparueshëm për personin e interesuar.

3. Në rastet e përmendura në pikën 2 të këtij neni, kur vendimi në konflikt përcakton, ndër të tjera, detyrimin për pagimin e detyrimeve të akcizës, pezullimi i këtij vendimi duhet të kushtëzohet me depozitimin e një garancie, në masën e plotë të detyrimit të akcizës.

Neni 107
Ndihma e institucioneve të tjera

Të gjitha institucionet publike civile, si dhe Policia e Shtetit janë të detyruara të ndihmojnë, të japin akses në informacion si dhe të bashkëpunojnë me autoritetet doganore sa herë që këto të fundit e kërkojnë ndihmën e tyre për zbatimin e këtij ligji.

Seksioni 20
Dispozitat e fundit

Neni 108
Nxjerrja e akteve nënligjore

Ngarkohen Këshilli i Ministrave, Ministri i Financave dhe Drejtori i Përgjithshëm i Doganave për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji, përfshirë këtu aktet për përcaktimin e modaliteteve për zbatimin e pullave fiskale, duke përfshirë, por jo vetëm, prodhimin, pagesën e taksës së akcizës dhe shpenzimet për prodhimin e zbatimin e pullave të akcizës dhe kodin e sigurisë, të personave të autorizuar për të prodhuar dhe zbatuar, dhe karakteristikat e të dhënave që përmbajnë kodet e sigurisë së pullave të akcizës, si dhe dispozita të tjera, që lidhen me mallrat e akcizës, që duhet të aplikohen në pullat e akcizës dhe kodet e sigurisë.

Neni 109
Dispozita kalimtare

1. Brenda një muaji pas botimit të këtij ligji në Fletoren Zyrtare, ngarkohen Këshilli i Ministrave dhe Ministri i Financave të miratojnë aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.

2. Nga data e miratimit të akteve nënligjore, në zbatim të këtij ligji, deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të gjithë tatimpaguesit, të cilët operojnë me mallra akcize, duhet të ndërmarrin masat e nevojshme që të përshtatin veprimtarinë e tyre me të gjitha kërkesat e këtij ligji.

3. Nga data e miratimit të akteve nënligjore, në zbatim të këtij ligji, deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të gjithë tatimpaguesit, të cilët operojnë me mallra akcize, në bazë të ligjit nr. 8976, datë 12.12.2002 "Për akcizat", të ndryshuar, duhet të paraqiten pranë administratës doganore për të aplikuar për pajisjen me autorizimet e nevojshme, në varësi të aktivitetit që ato kryejnë, si dhe të pajisjen me kodin e akcizës. Të gjitha autorizimeve ekzistuese, të lëshuara nga administrata tatimore, në bazë të ligjit nr. 8976, datë 12.12.2002 "Për akcizat", të ndryshuar, me hyrjen në fuqi të këtij ligji, u pushojnë efektet juridike.

4. Modalitetet e mbylljes së regjimit si tatimpagues akcize, sipas ligjit nr. 8976, datë 12.12.2002 "Për akcizat", të ndryshuar, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. Gjatë periudhës kalimtare, nga data e miratimit të akteve nënligjore, në zbatim të këtij ligji, deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, autoritetet doganore kanë të drejtën e kontrollit mbi të gjithë tatimpaguesit, të cilët operojnë me mallra akcize, në bazë të ligjit nr. 8976, datë 12.12.2002 "Për akcizat", të ndryshuar, me qëllim mbikëqyrjen dhe kontrollin e plotësimit të të gjitha kërkesave të përcaktuara për çdo tatimpagues nga ky ligj.

6. Gjatë kësaj periudhe kalimtare, deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të vazhdojnë të zbatohen procedurat e parashikuara në ligjin nr. 8976, datë 12.12.2002 "Për akcizat", të ndryshuar, si dhe aktet nënligjore, të dala në zbatim të tij.

7. Gjatë muajit korrik 2012, subjektet duhet të bëjnë deklarimin dhe pagesën e akcizës, për muajin qershor 2012, pranë administratës tatimore, sipas procedurave të përcaktuara në ligjin nr. 8976, datë 12.12.2002 "Për akcizat", të ndryshuar.

8. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohen ligji nr. 8976, datë 12.12.2002 "Për akcizat", i ndryshuar, të gjitha aktet nënligjore, të dala në zbatim të tij, si dhe çdo dispozitë tjetër, që bie ndesh me këtë ligj.

Neni 110
Hyrja në fuqi

Ky ligj botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi më 1 tetor 2012, ndërsa pikat 1, 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7 të nenit 109 të këtij ligji hyjnë në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 24.5.2012

Shpallur me dekretin nr.7733, datë 7.8.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

SHTOJCA NR. 1
MALLRAT E TATUESHME ME AKCIZË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË
(ndryshuar me ligjin nr.180/2013, datë 28.12.2013, nr. 142/2014, datë 23.10.2014, 158/2014, datë 27.11.2014 dhe 140/2015, datë 17.12.2015, nr. 126/2016, datë 15.12.2016; zëvendësuar me ligjin nr. 108, datë 30.11.2017, nr. 98/2018, datë 3.12.2018)

IKAFEKAFE

II BIRRË, VERË, ALKOOLDH

EPIJEALKOOLIKE

II DUHANDHENËNPRODUKTETETIJ

IV PRODUKTET ENERGJETIKE

E300 Vajra minerale	27071010 27071090 27072010 27072090 27073010 27073090 27075010 27075090	Produktet e vajrave minerale që i përkasin kodeve NK të kreut 2707	50 lekë/litri	
E400	27 10 12 11	Naftë që kërkon një proces specifik përpunimi	50 lekë/litri	
E410	27 10 12 41 27 19 12 45 27 10 12 49	Vajra të lehta (benzinë dhe benzol) Benzinë dhe benzol pa plumb, me përmbajtje plumbi jo më tepër se 0,013 gr/litër Me më pak se 95 oktan Me 95-98 oktan Me 98 e më shumë oktan	37 lekë/litri	
E420	27 10 12 51 27 10 12 59	Benzinë me plumb, me përmbajtje plumbi më tepër se 0,013 gr/litër Me më pak se 98 oktan Me 98 e më shumë	50 lekë/litri	

		oktan		
E430	27 10 19 11 deri 27 10 19 29 27 10 19 21 deri 27 10 19 25	Vajguret Karburantet, tip vajguri	20 lekë/litri 20 lekë/litri	
E440	27 10 19 31 deri 27 10 19 48	Vajra të rënda (gazoil)	37 lekë/litri	
E450	27 10 19 51 deri 27 10 19 69	Vajra të rënda si lëndë djegëse (lëndëdjegëse, solar,mazut)	37 lekë/kg	
E460	2710 20	Biodiesel me vajra nafte	37 lekë/kg	
E470	27 10 19 71 deri 27 10 19 99	Vajra lubrifikante dhe vajra të tjera	40 lekë/kg	
E471	27 109 100 deri 27109900	Mbetje vajrash	5 lekë/kg	
E472	27 12 10 90	Graso	40 lekë/kg	
E480	27 13 11 00 27 13 12 00	Koks nafte	2 lekë/kg	
E490	27 13 20 00	Bitum nafte	5 lekë/kg	
E490	27 13 90	Mbetje të vajrave të naftës dhe të mineraleve bituminoze (bitumen)	5 lekë/kg	
E491	27 15	Përzierje bituminoze të bazuara në asfaltin natyror, në bitumen e naftës, në katranin mineral, ose në terpentinën e katranit mineral (masticet bituminoze) Vernik Bituminoz (psh asfalto-beton)	5 lekë/kg bitum	
E492	27 14 90 00	Zhavor bituminoz	0,3 lekë/kg	
E500 Gazet e naftës dhe hidrokarbure të tjera gazoike	27111211 27111219 27111291 27111293 27111294 27111297 27111310 27111330 27111391 27111397 27111400	Gazet e naftës dhe hidrokarbure të tjera gazoike për përdorim si lëndë djegëse për motor automjetesh.	8 lekë/litri	

E501 Gaze të naftës dhe Hidrokarbure të tjera gazoike	27111211 27111219 27111291 27111293 27111294 27111297 27111310 27111330 27111391 27111397 27111400	Gazet e naftës dhe hidrokarbure të tjera gazoike për përdorim të ndryshëm nga ai si lëndë djegëse për motor automjetesh.	0 lekë/litri	
E600 Hidrokarburet aciklike	2901	Hidrokarburet aciklike	37 lekë/kg	
E700 Hidrokarburet ciklike	2902	Hidrokarburet ciklike	37 lekë/kg	
E800 Metanol (Alkooli metilik)	29051100	Metanol (Alkooli metilik)	Sipas përcaktimeve të neneve 50 e 51 të ligjit	
L000	34 03 19 10 34 03 99 00	Preparate për lubrifikimin e makinerive, pajisjeve dhe automjeteve	40 lekë/kg	
L000 Preparatet antiplasëse, frenues oksidimi; Alkibenzenet e përziera	3811 dhe 3817	Preparatet antiplasëse, frenues oksidimi, stabilizator rrëshire, përmirësues viskoziteti, kundër korrozionit, dhe elemente shtesë të përgatitura për vajrat minerale (përfshirë benzinën) apo lëngje të tjera të përdorura për qëllime të tjera si vajrat minerale Alkibenzenet e përziera dhe Alkinaftalenet e përziera	Sipas përcaktimeve të neneve 50 e 51të ligjit	
E920 Biodiezel	3826 00	Acidet yndyrore /Biodiezel me më pak se 70% vajra nafte të kapitullit 27	37 lekë/litri	
V FISHEKZJARRËT				
F000 Fishekzjarrët	36 04 10 00	Fishekzjarrët	200 lekë/kg	
F000	36 04 90 00	Të tjera	200 lekë/kg	
VI GOMAT				
P100 Goma të reja	40 11	Goma të reja pneumatike prej gome	20 lekë/kg	
P200 Goma të riveshura	40 12 (përveç 40 12 20 00)	Goma pneumatike të riveshura; goma mishi apo të zakonshme; veshja e jashtme	40 lekë/kg	

		(pjesa me lule) dhe fashetat e gomës		
P300 Goma të përdorura	40 12 20 00	Goma pneumatike të përdorura	100 lekë/kg	
VII PILAT DHE BATERITË PRIMARE; AKUMULATORËT ELEKTRIKË				
A200 Akumulatorët	85 07	Akumulatorët elektrikë, përfshirë ndarëset e tyre, nëse janë apo jo drejtkëndëshe (përfshirë katrorët)	20 lekë/kg	

SHTOJCA NR. 2
ÇMIMI (DUKE PËRJASHTUAR TVSH-NË DHE ÇDO TAKSË TJETËR APO DETYRIME PULLE TË APLIKUESHME, SIPAS LIGJIT SHQIPTAR) PËR ÇDO PULLË FISKALE INDIVIDUALE TË PRODHUAR DHE TË SHPËRNDARË NGA KONCESIONARI

Produkti	**Lloji i pullës fiskale**	**Çmimi për një mijë (në €, përjashto TVSH-në dhe taksa të tjera)**
Duhan	Pulla e akcizës	€ 20.00
Alkool	Pulla e akcizës	€ 32.00
Birrë	Kodi i sigurisë/ Pulla e akcizës	€ 22.00